



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 269 Akti

Nr. 282 Vendimi
Tiranë, më 28.7.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

në prezencë të vëzhgueses ndërkombëtare, znj Elka Ermenkova, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në datën 24.7.2020, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Anisa Qilimi**, me detyrë prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Znj. Anisa Qilimi është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit si prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
2. Znj. Anisa Qilimi bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.1.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Pamela Qirko dhe Xhensila Pine relatore.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në

vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Etleda Çiftja. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, në datën 8.6.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi, bazuar mbi rezultatet e hetimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera thirrje dëshmitari dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Përmes postës elektronike të datës 9.6.2020 trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën për të sjellë prova për të provuar të kundërtën, deri në datën 20.6.2020.

7. Në datën 19.6.2020, subjekti i rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi ka depozituar shpjegimet dhe provat të cilat janë administruar dhe analizuar nga trupi gjykues.

8. Trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, duke respektuar masat mbrojtëse nga COVID-19, të miratuara sipas udhëzimeve të autoriteteve shtetërore, në praninë edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në datën 24.7.2020, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

9. Bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi, bazuar në të tri kriteret e rivlerësimit: i pasurisë; i figurës; dhe i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Në datën 24.7.2020, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, u paraqit personalisht në seancë. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi, kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 24.7.2020 u ndërpre për të vazhduar në datën 28.7.2020 me shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Subjekti i rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi, ka qenë bashkëpunuese sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

12. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (LDKPKI) ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi. Në përfundim të veprimeve verifikuese ILDKPKI-ja bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

13. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; për verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

14. Në Deklaratën e pasurisë “Vetting”, subjekti i rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi, ka deklaruar:

14.1 Kontratë depozite bankare, nr. reference ****, datë 11.4.2014, në “Intesa Sanpaolo Bank”. Principali i depozitës: 5.118 euro. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: kursime nga paga.

14.2 Kontratë depozite bankare, nr. reference *****, datë 11.12.2015, në BKT (Banka Kombëtare Tregtare). Depozita me interes 2.05 %, afat tre vjet, vlera 600.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: kursime nga paga.

14.3 Autoveturë tip “O”, me targa TR *** R , datë prodhimi 29.12.1998, çmimi i blerjes 6.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kursime nga pagat, si dhe hua nga z. I. Q (babai) në vlerën 3.000 euro, shlyer në vitin 2015, pasqyruar në deklaratën e dorëzuar në datën 30.3.2016.

15. Personat e lidhur, prindërit e subjektit, z.I.Q dhe znj S.Q, kanë deklaruar në Deklaratën e pasurisë “Vetting”, bashkërisht pasuritë 50 %, si më poshtë:

15.1 Apartament me sipërfaqe 54 m², me adresë Rr. “Z. C”, p. **, shk. **, ap. **, Tiranë. Blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesave në datën 16.5.1994, regjistruar në emër të prindërve të subjektit. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga, ndër vite, të prindërve të subjektit. Pasuri e përbashkët e vënë pas lidhjes së martesës. Vlera: 10.250 lekë. Pjesa takuese: 50 % për secilin bashkëshort.

15.2 Apartament me sipërfaqe 69.4 m², me adrese Rr. “Z. C,” p. **, shk. **, ap. **, Tiranë. Blerë nga prindërit dhe familja e vëllait të subjektit, me kusht, sipas kontratës datë 15.12.2001. Origjina: ky apartament është shitur nga Ndërmarrja Komunale Banesave përkundrejt vlerës

1.790 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat personale të prindërve të subjektit. Pasuri e përbashkët e vënë pas lidhjes së martesës. Vlera: 300.000 lekë. Pjesa takuese: 50 % për secilin bashkëshort.

15.3 Depozitë pa afat në “Credins Bank”, kontratë lidhur në datën 30.8.2016, regjistruar në emër të subjektit dhe të bashkëshortes. Burimi i krijimit: të ardhurat personale dhe të bashkëshortes. Bashkëlidhur kontrata e depozitës pa afat nr. ****, datë 30.8.2016 dhe printim i balancës datë 24.1.2017. Vlera: 2.500 euro. Pjesa takuese: 50 % për secilin bashkëshort.

15.4 Llogari në “Raiffeisen Bank”, regjistruar në emrin e babait të subjektit. Burimi i krijimit: të ardhurat personale dhe të bashkëshortes, ndër vite. Llogaria aktuale është disa vjeçare. Vlera: 13.983 euro. Pjesa takuese: 50 % për secilin bashkëshort.

16. Nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. S. Q në Deklaratën e pasurisë “Vetting”, ka deklaruar, përveçse sa më lart, edhe pasuritë e mëposhtme:

17. Aksione në shoqërinë “T-X” sh.a., që përbëjnë 0.658 % (73 aksione) të kapitalit të shoqërisë me burim nga të ardhurat e pagave ndër vite. Vlera e bonove të privatizimit: 235.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

17.1 Aksione në tërësi 1.7474% në shoqërinë “A. K” sh.a. Burimi i krijimit: bono privatizimi dhënë nga shteti; bono privatizimi blerë në treg me 20%-të ardhura nga paga; si dhe bono privatizimi dhënë nga prindërit. Aktualisht të shituara sipas kontratës datë 16.12.1998. Vlera: 715.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

18. Për kontratë depozite bankare, nr. reference *****, datë 11.4.2014, në “Intesa Sanpaolo Bank”. Principali i depozitës: 5.118 euro. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: kursime nga paga.

18.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *“Shumë e investuar në depozitë 2.500 Euro në “Intesa Sanpaolo Bank” . Data e depozitimit 1.4.2011. Burimi i krijimit: kursime nga paga”*.

18.2 Fillimisht depozita është çelur në datën 1.4.2011, në vlerë 2.500 euro në “Intesa Sanpaolo Bank”. Më pas në datën 11.4.2014, pas depozitimit të shumës 2.500 euro, *cash*, është lidhur kontratë e re depozitë. Historiku i depozitës pasqyrohet në deklaratën e dorëzuar në datën 19.3.2012, si dhe në deklaratën e dorëzuar më 25.3.2015.

18.3 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, subjekti ka deklaruar: *“Depozitim cash 2500 euro në datë 11.4.2014 në Intesa Sanpaolo Bank . Burimi i krijimit: kursime nga paga”*.

18.4 Për të verifikuar deklarin e subjektit lidhur me disponimin e investimit në depozita bankare, Komisioni kreu hetim në përfundim të të cilit rezultoi se subjekti në datën 1.4.2011 ka derdhur depozitë në shumën 2.500 euro si dhe në datën 11.4.2014 ka derdhur depozitë shumën 2.500 euro, me gjendje totale në datën 11.4.2014 në shumën 5.118 euro.

Lidhur me burimin për krijimin e depozitës deklaruar me kursimet nga paga

18.5 Komisioni iu referua deklarimeve vjetore të kryera nga subjekti para vitit 2011 (vitet të investimit) deri në vitin 2013 për të evidentuar mbi gjendjen e kursimeve të deklaruara, nga ku u konstatua se:

- Në DPV-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 400.000 lekë, gjendje e cila sipas subjektit¹ është përdorur për blerjen e automjetit në vitin 2009.

¹Pergjigje 3 të pyetësorit të dytë.

- Në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar: “Kursime nga paga personale mujore në vlerën 1.500 euro në masën 100 % (pjesë takuese)”.

- Në DPV-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar: “Kursime nga paga në vlerën 150.000 lekë të reja të ndodhura në gjendje cash, në masën 100 % (pjesë takuese)”.

- Në DPV-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar gjendje cash: “Kursime nga paga në vlerën 150.000 lekë të ndodhura në gjendje cash, në masën 100 % (pjesë takuese)”.

- Në DPV-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar gjendje cash: “Kursime nga paga në vlerën 150.000 lekë në masën 100% (pjesë takuese)”.

18.6 Për shkak se subjekti nuk kishte deklaruar pakësim të gjendjes cash në vitet e kryerjes së investimit, Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me përdorimin e gjendjes cash të deklaruar si kursim, e cila ka sqaruar ndër të tjera se: “Gjendja cash ne euro ose në lekë nga viti 2010 dhe në vijim është përdorur për depozitë në vitin pasardhës...”.

18.7 Analiza financiare lidhur me mundësitë për investime në depozitë

18.7.1 Lidhur me mundësinë e subjektit për të investuar shumën 2500 euro në depozitë me afat në “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 1.4.2011, Komisioni ka përgatitur analizën financiare për këtë investim në depozitë, duke konsideruar të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet për periudhën 1.1.2011 – 1.4.2011, në përputhje me deklarimin e subjektit në DPV-në e vitit 2011. Mbështetur në deklarimin e subjektit në DPV-në e vitit 2011, Komisioni nuk ka konsideruar në këtë analizë gjendjen cash të një viti më parë për sa subjekti nuk ka deklaruar pakësimin sikurse kërkohet nga ligji nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive”.

Në përfundim të analizës financiare për vitin 2011, subjekti rezultoi me një balancë pozitive në vlerën prej 47.990 lekësh.

18.7.2 Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për të investuar vlerën 2.500 euro në datën 1.4.2011, në depozitë me afat në “Intesa Sanpaolo Bank”.

18.7.3 Lidhur me investimin në depozitë në vlerën 2.500 euro të kryer në datën 11.4.2014 në “Intesa Sanpaolo Bank”, Komisioni ka përgatitur analizën financiare për këtë investim në depozitë, duke konsideruar të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet për periudhën 1.1.2014 – 11.4.2014, në përputhje me deklarimin e subjektit në DPV-në e vitit 2014. Mbështetur në deklarimin e subjektit në DPV-në e vitit 2014, Komisioni nuk ka konsideruar në këtë analizë gjendjen cash të një viti më parë për sa subjekti nuk e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2014 në formën e pakësimit sikurse kërkohet nga ligji nr. 9049, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive”.

18.8 Analiza financiare në datën 11.4.2014 rezultoi, si më poshtë:

Analiza financiare	11.04.2014
PASURI	747,986
Ndryshim likuiditeti	747,986
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	5,075,981
DETYRIME	0
PASURI NETO	747,986
TË ARDHURA	760,055
Të ardhura subjekti (paga) 1.1.2014 – 11.4.2014	327,276

Të ardhura nga interesi i depozitës pranë Intesa Sanpaolo Bank 1.1.2014 – 11.4.2014	17,359
Të ardhura babai (pensioni) 1.1.2014 – 11. 4.2014	77,846
Të ardhura babai nga interesat e depozitës me afat në BKT 1.1.2014 – 11.4.2014	1,553
Të ardhura nëna nga pagat 1.1.2014 – 11.4.2014	336,021
SHPENZIME	189,519
Shpenzime jetese për 3 persona 1.1.2014 – 11.4.2014	176,319
Shpenzime udhëtimi Tiranë - Krujë – Tiranë 1.1.2014 – 11.4.2014	13,200
Analiza	-177,451

18.9 Subjekti nuk ka pasur mundësi për të investuar në datën 11.4.2014 shumën 2.500 euro në depozitë me afat në “Intesa Sanpaolo Bank”, duke rezultuar me një balancë negative në shumën -177,451 lekë.

18.10 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua e drejta të paraqiste shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën e rezultatit negativ financiar të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

18.11 Pas kalimit të të drejtës për të paraqitur shpjegime, subjekti ka sqaruar:

Lidhur me investimin në depozitë në shumën 2,500 euro të kryer në datë 11.04.2014 pranë ISPA Bank sha, Komisioni në analizën financiare të përgatitur për periudhën 01.01.2014 - 11.04.2014 nuk ka konsideruar në këtë analizë gjëndjen cash të një viti më parë për sa subjekti nuk e ka deklaruar në DPV 2014 sikurse kërkohet nga Ligji nr. 9049, për të cilën bazuar në nenin 52 të Ligjit 84/2016, më është kaluar barra e provës.

Kundërshtoj analizën e kryer nga Komisioni pasi gjëndja cash në fund të vitit 2013 duhet marrë në konsideratë ose në vlerën 1,058,215 lekë sipas DPV-ve ose 150,000 lekë sipas përgjigjes së pyetësorit, por në asnjë rast nuk duhet që mos të konsiderohet.

Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm

18.12 Në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, deklarata e pasurisë për vitin 2014, është provë që vërteton pranimin ose rrëzimin e pretendimeve të subjektit në proces.

18.13 Sqarimi i dhënë nga subjekti se vlerën prej 2.500 euro në “Intesa Sanpaolo Bank” u krijua duke u pakësuar gjëndja *cash*, trupi gjykues vlerëson se nuk provohet nga deklarata periodike e subjektit të rivlerësimit në vitin 2014.

18.14 Trupi gjykuese vlerëson se referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 – 33 të ligjit nr. 84/2016, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit në deklaratën “Vetting” dhe atyre periodike, si dhe deklarimet e subjektit mbi faktet e dala gjatë hetimit administrativ.

18.15 Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi matet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota.

18.16 Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarimin e çdo pasurie, të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë dhe likuiditetet në formën e cash-it, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se marrja në konsideratë e këtij likuiditeti përfaqëson një argument që nuk mbështetet në ligjin nr. 9043/2003, ndryshuar, i cili ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti rivlerësimi për të deklaruar çdo shtesë e pakësim të pasurisë në çdo formë që ndodh përgjatë një viti periodik.

18.17 Përdorimi *cash* që nuk është deklaruar si pakësim është qartësuar e konsoliduar nga vendimmarrjet e Kolegjit të Apelimit ku ndër të tjera orientohet Komisioni se: [...] *për zgjidhjen e çështjeve² të ngjashme në të ardhmen ...të mos prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklarata periodike [...].*

18.18 Trupi gjykues vlerëson në konkluzion se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për diferencën negative financiare të datës 11.4.2014.

19. Kontratë depozite bankare, nr. reference *****, datë 11.12.2015, në BKT (Banka Kombëtare Tregtare). Depozita me interes 2.05 %, afat tre vjet. Vlera: 600.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

19.1 Depozita është çelur në “Raiffeisen Bank” dhe në datën 11.12.2015 është tërhequr shuma 701.000 lekë. Nga kjo shumë, po në datën 11.12.2015, është bërë depozitim dhe çelje e depozitës në “BKT” në vlerën 600.000 lekë.

19.2 Komisioni verifikoi deklaratimet periodike të subjektit lidhur me pasurinë depozitë bankare, nga ku rezultoi:

- Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar : *“Shumë e investuar në depozitë 400.000 lekë në Raiffeisen Bank. Data e depozitimit 13.4.2012. Kursime nga paga.”*

- Në DPV-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar: *“Depozitim në llogarinë personale ekzistuese në datën 15.4.2013, në vlerën 300.000 lekë në Raiffeisen Bank. Kursime nga paga. Si rezultat i shtesës së vlerës në llogarinë personale depozita me afat shkon në tërësi në 700.000 lekë sipas kontratës së depozitës me afat datë 15.4.2013”*.

- Në DPV-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar *“Nga shuma e tërhequr më lart në Raiffeisen Bank po në dt. 11.12.2015 depozitim cash në BKT në vlerën 600.000 lekë. Çelje e kontratës së depozitës bankare me nr. ref. BKT *****, me interes 2.05%, afat 3 vjet.”*

19.3 “Raiffeisen Bank”, konfirmon hapje depozite në datë 13.4.2012 në shumën 400.000 lekë.

² Vendimi (JR) nr. *** dhe nr. 11/2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Vendimi (JR) nr. 11/2019, i cili përcakton se: [...] Referuar nenit 4, pika 1, shkronja “d” e të njëjtit ligj, në objektin e deklaratimit, sipas kësaj dispozite, përfshihet në konceptin e pasurisë së deklarueshme edhe vlera e likuiditeteve në gjendje cash, për të cilat, si për çdo pasuri tjetër, duhet të deklarohet gjendja deri më 31 dhjetor, në raport me deklarimin e mëparshëm mbi të njëjtën pasuri. [...] Gjithashtu, neni 7 i të njëjtit ligj përcakton në mënyrë të shprehur se në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji. Në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore, janë miratuar edhe modelet e formularëve të deklaratimeve periodike, të cilat, në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe interesave private, në shpjegimet orientuese për subjektet lidhur me mënyrën e deklaratimit, udhëzojnë: Përkthuesi hollësisht ndryshimet (shtesat, pakësimet) [...] të çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklaratimit. [...] [...] “25 Para miratimit të përmbajtjes aktuale të këtij neni, me miratimin e ligjit nr. 85/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003”, ky detyrim ligjor përcaktohej shprehimisht në të njëjtën mënyrë nga neni 15, pika 7 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. [...] Faqe 19 nga 20.

19.4 Banka Kombëtare Tregëtare konfirmon hapje llogarie në datën 11.12.2015 depozitë në shumën 600.000 lekë. Nga administrimi i pasqyrës “*statement*” evidentohet përshkrimi: “*Anisa Qilimi derdh në llogari shumën 600.000 lekë tërhequr nga Raiffeisen Bank*”.

Analiza financiare

19.5 Komisioni përgatiti analizën financiare lidhur me mundësinë e subjektit për të investuar vlerën 400.000 lekë në depozitë më afat në “Raiffeisen Bank” në datën 13.4.2012 duke llogaritur të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet për periudhën 1.1.2012 – 13.4.2012.

19.6 Përmes kësaj analize rezultoi se subjekti ka pasur mundësi për të investuar vlerën 400.000 lekë në datën 13.4.2012, në depozitë me afat pranë “Raiffeisen Bank”, duke rezultuar me një balancë pozitive në shumën 104.526 lekë.

19.7 Komisioni përgatiti analizën financiare lidhur me mundësinë e subjektit për të investuar vlerën 300.000 lekë në depozitë më afat në “Raiffeisen Bank” në datën 15.4.2013 duke llogaritur të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet për periudhën 1.1.2013 – 15.4.2013.

19.8 Për sa ka rezultuar nga analiza financiare subjekti ka pasur mundësi për të investuar vlerën 300.000 lekë në depozitë me afat në “Raiffeisen Bank”, në datën 15.4.2013, duke rezultuar me një balancë pozitive në shumën 182.884 lekë.

20. Autoveturë tip “O”, me targa TR *** R, datë prodhimi 29.12.1998, çmimi i blerjes 6.000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

20.1 Burimi i krijimit: kursime nga pagat, si dhe hua nga z. I.Q (babai) në vlerën 3.000 euro, shlyer në vitin 2015.

20.2 Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 me vlerën 6000 euro, me pjesë takuese: 100%, si dhe ka deklaruar në rubrikën e detyrimeve financiare se ka marrë hua në shumën 3.000 euro për blerjen e këtij automjeti, të cilën e ka shlyer në vitin 2015. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 subjekti ka deklaruar shlyerjen e detyrimit.

20.3 Nga informacioni i marrë nga DPSHTRr-ja³, rezultoi se me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.1.2009, subjekti blen automjetin tip “O” nga shtetasi O.B, kundrejt çmimit 6.000 euro. Sipas kësaj kontrate është përcaktuar se çmimi është likuiduar dhe se palët nuk kanë asnjë lloj detyrimi ndaj njëri-tjetrit.

20.4 Sipas deklaratës doganore të datës 7.12.2008, ky automjet është blerë për vlerën 1.150 euro në Gjermani.

20.5 Nga administrimi i dokumentacionit rezultoi se këtë automjet subjekti e shet në datën 7.12.2018 në vlerën 80.000 lekë.

Lidhur me huanë 3.000 euro nga babai i subjektit si burim krijimi për automjetin

20.6 Për shkak të përcaktimit ligjor, parashikuar në pikën 4, të nenin 32, të ligjit nr. 84/2016 për të provuar mundësitë financiare të babait të saj për dhënie e huas në shumën 3000 euro, Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë mundësitë financiare të babait.

20.7 Lidhur me mundësinë e prindërve të subjektit për të kursyer shumën 3.000 euro, dhënë hua vajzës së tyre në datën 9.1.2009, nga subjekti është paraqitur dokumentacion⁴ për të provuar të ardhurat e prindërve nga punësimi.

³ Shkresë në dosjen e ILDKPKI-së me nr*** prot., datë 25.2.2019.

⁴Vërtetim page *bruto* dhe *neto* të lëshuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për të ardhurat e S. Q për periudhën 1.1.2003 – 31.10.2006.

20.8 Komisioni përgatiti analizën financiare për mundësinë e prindërve të subjektit për të kursyer shumën e dhënë hua prej 3.000 euro (411.510 lekë), duke konsideruar të ardhurat e tyre nga pagat e përfituara në periudhën 2001 – 2008.

20.9 Në analizën financiare janë konsideruar shpenzimet jetike për prindërit e subjektit⁵, investimet e krijuara në formë depozite bankare deri në datën 31.12.2008 sipas konfirmimit nga institucionet financiare⁶ dhe shuma e investuar për blerje apartamenti nga prindërit në vitin 2001⁷.

20.10 Në përfundim të analizës financiare rezultoi se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi për të grumbulluar kursime dhe për të dhënë hua në shumën 3.000 euro vajzës së tyre në vitin 2009, duke rezultuar me një balancë pozitive në shumën 1.264.053 lekë.

Lidhur me kursimet e subjektit nga paga, si burim krijimi për automjetin

20.11 Komisioni iu referua deklaratimeve të subjektit në deklaratimet, ndër vite, lidhur me gjendjen e kursimeve, nga ku u evidentua se:

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 ka deklaruar: “*Diferencë nga të ardhurat e përfituara nga viti i mëparshëm në shumën 400,000 lekë*”.

-Nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 për blerje automjeti në zbatim të detyrimeve ligjore sipas ligjit nr. 9049, “Për deklarimin e pasurive”.

20.12 Për rrjedhojë, Komisioni nuk e ka konsideruar këtë shumë *cash* si burim krijimi për blerjen e pasurisë së luajtshme automjet.

Analiza financiare

20.13 Komisioni përgatiti analizën financiare për subjektin lidhur me mundësinë financiare për blerjen e automjetit në çmimin 6.000 euro në datën e blerjes së automjetit 8.1.2009.

Analiza financiare	8.1.2009
PASURI	878,428
Automjet tip “O. A” kontratë shitblerje nr. ***, datë 8.1.2009.	823,020
Ndryshim likuiditeti	55,408
Total likuiditete deklaruar	1,180,954
DETYRIME	411,510
Hua në shumën 3.000 euro nga prindërit	411,510
PASURI NETO	466,918
TË ARDHURA dokumentuar	77,474
Të ardhura (paga) 1.1.2009 – 8.1.2009	65,280
Të ardhura babai (paga) 1.1.2009 – 8.1.2009	12,194

Vërtetim për bazën e vlersueshme dhe pagën mesatare të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të ardhurat e S. Q për periudhën 1.11.2006 – 31.5.2018.

Vërtetim për bazën e vlersueshme dhe pagën mesatare të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të ardhurat e I. Q për periudhën 1.1.2001 – 1.6.2013.

⁵ Shkresë ILDKPKI-së me nr.*** prot., datë 4.3.2019.

⁶ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.4.2020, nga “Raiffeisen Bank”, për I dhe S. Q.

⁷ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.3.2019, nga ZVRPP-ja.

SHPENZIME	8,983
Shpenzime jetese (3 persona) 1.1.2009 – 8.1.2009	8,983
Analiza dokumentuar	-398,427

20.14 Nga analiza financiare subjekti nuk ka pasur mundësi për të investuar në blerjen e automjetit në vitin 2009 duke rezultuar me një diferencë negative në shumën -398.427 lekë.

20.15 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua e drejta të paraqiste shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën e rezultatit negativ financiar të Komisionit.

20.16 Pas kalimit të të drejtës për të paraqitur shpjegime/prova, subjekti ka kundërshtuar vlerësimin e kryer nga Komisioni për mos konsiderimin e gjendjes *cash* në shumën 400.000 në fund të vitit 2008 si burim për krijimin e pasurisë automjet tip “O”, duke sqaruar , ndër të tjera : “... *plotësimi i deklaratës periodike vjetore për vitin 2008 është bërë në datën 24.3.2009 mbasi unë e kisha blerë automjetin. Është fakt që në këtë datë që si burim krijimi për blerjen e automjetit ka shërbyer kursimi i gjendjes cash në fund të vitit 2008 dhe huaja e marrë nga prindërit (babai). Në plotësimin e DPV-së të vitit 2009 kam deklaruar huan e marrë nga babai që shërbeu për plotësimin e të gjithë shumës 6.000 euro. Komisioni nuk mund të mos llogarisë kursimet cash në fund të vitit 2008. Në datën 31.12.2008 kam deklaruar gjendje cash 400.000 lekë dhe pas tetë ditësh kam blere mjetin dhe është mëse logjike që shuma cash prej 400.000 lekësh të përdorej pas tetë ditësh për blerjen e mjetit.*

Në lidhje me deklarin e gjendjes cash deklaruar nga ana ime në DPV-të vjetore, kërkoj të shpjegoj se kam deklaruar në DPV-në e vitit 2008 për herë të parë gjendje cash në shumën 400,000 lekë me burim krijimi nga kursimet e pagave për vitin 2008...”

Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm

20.17 Në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, deklarata e pasurisë për vitin 2009, është provë që vërteton pranimin ose rrëzimin e pretendimeve të subjektit në proces.

20.18 Subjekti ka patur detyrimin ligjor sipas ligjit 9049, “Për deklarimin e pasurive” të deklarojë në DPV-në e vitit 2009 pakësim të gjendjes *cash* për këtë vit për shkak të blerjes së automjetit me burim kursimet e deklaruara në vitin e mëparshëm në shumën 400.000 lekë. Për rrjedhojë, në analizën financiare është konsideruar si burim blerje të automjetit vetëm shuma e dhënë hua nga i ati i subjektit.

20.19 Trupi gjykues vlerëson deklarinimi i subjektit se ka blerë automjetin duke përdorur gjendjen *cash* të vitit 2008, nuk provohet nga deklarata periodike e subjektit të rivlerësimit në vitin 2009.

20.20 Trupi gjykuese vlerëson se duke iu referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 – 33 të ligjit nr. 84/2016, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit “Vetting” dhe atyre periodike, mbi faktet e dala gjatë hetimit administrativ.

20.21 Trupi gjykues vlerëson në konkluzion se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për diferencën negative financiare të datës datë 8.1.2009.

Trupi gjykues arriti në përfundimin se me të ardhurat e ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, sipas përcaktimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti

rezulton me një bilanc negativ në ditën e investimeve në vlerën: prej -398.427 lekësh në datë 8.1.2009; dhe vlerën 177.451 në datë 11.4.2014, në total në vlerën - 575.878 lekë.

21. Personat e lidhur, babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit, kanë deklaruar:

i) Apartament me sip. 54 m², me adresë Rr. “Z. C”, p. **, shk. **, ap. **, Tiranë. Blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesave në datën 16.5.1994, regjistruar në emrin e prindërve të subjektit. *Burimi i krijimit:* të ardhurat nga paga, ndër vite. Pasuri e përbashkët e vënë pas lidhjes së martesës. Vlera: 10.250 lekë. Pjesa takuese: 50% për secilin bashkëshort.

Nga hetimi i Komisionit⁸, rezultoi se pasuria apartament me sip. 54 m² është e regjistruar në pronësi të prindërve të subjektit I dhe S.Q, e përfituar nëpërmjet privatizimit të banesave shtetërore me kontratë me Ndërmarrjen Komunale Banesa.

✓ Deklarimi i personave të lidhur përputhej me rezultatin e hetimit.

ii) Apartament me sip. 69.4 m², me adrese Rr. “Z. Ç”, p. **, sh. **, ap. **, Tiranë. Blerë nga prindërit, me kusht, sipas kontratës datë 15.12.2001. Origjina: ky apartament është shitur nga Ndërmarrja Komunale Banesave përkundrejt vlerës 1.790 lekë te afermve te babait te subjektit. *Burimi i krijimit:* të ardhurat personale dhe të bashkëshortes. Pasuri e përbashkët e vënë pas lidhjes së martesës. Vlera: 300.000 lekë. Pjesa takuese: 50 % për secilin bashkëshort.

Nga hetimi i Komisionit⁹, rezultoi se pasuria apartament me sip. 69.4 m² është e regjistruar në pronësi të z. I.Q, e përfituar sikurse ka deklaruar babai i subjektit nëpërmjet kontratës së shitblerjes të lidhur me pjesëtarët e familjes se tij.

✓ Deklarimi i personave të lidhur përputhej me rezultatin e hetimit.

iii) Depozitë pa afat në “Credins Bank”, kontratë lidhur në datën 30.8.2016, regjistruar në emrin tim dhe të bashkëshortes.

Burimi i krijimit: të ardhurat personale dhe të bashkëshortes. Vlera 2.500 euro. Pjesa takuese: 50 % për secilin bashkëshort.

Nga dokumentacioni¹⁰ i administruar nga Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 11.7.2017, të “Credins Bank”, konfirmohet kjo llogari.

✓ Deklarimi i personave të lidhur përputhej me rezultatin e hetimit.

iv) Llogari në “Raiffeisen Bank”. *Burimi i krijimit:* të ardhurat personale dhe të bashkëshortes. Llogaria aktuale është disa vjeçare. Vlera: 13.983 euro. Pjesa takuese: 50 % për secilin bashkëshort.

Nga hetimi i Komisionit, me shkresën me nr. *** prot., datë 20.2.2019, të “Raiffeisen Bank”, konfirmohet kjo llogari.

✓ Deklarimi i personave të lidhur përputhej me rezultatin e hetimit

22. Nëna e subjektit – S. Q – përveç sa më sipër ka deklaruar:

v) Aksione në shoqërinë “T-X” sh.a., që përbëjnë 0.658 %(73 aksione) të kapitalit të shoqërisë. *Burimi i krijimit:* nga të ardhurat e pagave në vite. Vlera e bonove të privatizimit: 235.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Komisioni kreu hetim për të verifikuar mbi këto aksione nga ku, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.2.2019, të QKB-së konfirmohet deklarimi i personit të lidhur

⁸ Shkresë nr. *** prot datë 07.03.2019 të ZVRPP Tiranë

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 7.3.2019, të ZVRPP-së Tiranë.

¹⁰Shkresë nga “Credins Bank” në dosjen e ILDKPKI-se seksioni 19.

në lidhje me aksionet e mbajtura në shoqërinë “T-X” sh.a. Nga informacioni i marrë rezultoi se kjo shoqëri fillimisht ishte regjistruar me vendimin nr. ***, datë 3.5.1996, në emrin “Sh” sh.a.

Komisioni kreu hetim për të verifikuar nëse personi i lidhur me subjektin kishte përfituar të ardhura nga shpërndarja e dividendit në shoqërinë “T-X” sh.a., nga ku rezultoi se me shkresën nr. ***, datë 12.3.2019, të Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë konfirmon se znj. S.Q është aksionare në shoqërinë “T-X” sh.a., që në vitin 2015. Më tej, informon se shoqëria ka deklaruar të ardhura nga shitja mbi të cilin ka paguar tatimet. Gjithashtu, informon se shoqëria nuk ka shpërndarë dividend.

vi) Aksione që përbëjnë 1.7474% në shoqërinë “A. K” sh.a., krijuar në bazë të vendimit nr. ****, datë 13.6.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Burimi i krijimit: bono privatizimi dhënë nga shteti; bono privatizimi blerë në treg me 20%; të ardhura nga paga; si dhe bono privatizimi dhënë nga prindërit e mi. Aktualisht të shituara sipas kontratës datë 16.12.1998. Vlera: 715.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se me kontratën e shitjes së kuotave¹¹ midis S.Q, M K. B dhe S. Q i ka shitur kuotat e zotëruara në këtë shoqëri në vitin 1998 në masën 100 %.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve¹², ka rezultuar se sipas regjistrimeve në sistemin informatik nuk rezultojnë të dhëna për subjektin “A.K” sh.a.

✓ Deklarimi i personave të lidhur përputhej me rezultatin e hetimit.

23. Lidhur me pasuritë e personave të lidhur, pas kryerjes së hetimit, trupi gjykues arrin në përfundimin se deklaratimet e personave të lidhur përputhen me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ. Pas administrimit dhe vlerësimit të tyre, nuk konstatohen problematika në lidhje me pasurinë e personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

ÇËSHTJE TË TJERA

24. Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave¹³ është evidentuar raportimi i një transaksioni në datën 5.9.2013, në vlerën 125.000 lekë me përshkrimin “kreditim për llogari pagesë për licencë avokatie Anisa Qilimi”.

25. Në përgjigje, pyetur nga Komisioni subjekti ka sqaruar se: *“Në vitin 2004 aplikova për as/avokate dhe ushtrroja praktikën pranë një studioje ligjore. Pas një viti konkurrova dhe fitova në profilin prokuror në Shkollën e Magjistraturës. Kam vijuar punën dhe në vitin 2013 vendosa të marr pjesë në provimin e kryer nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, me qëllim fitimin e titullit ‘Avokat’. Në vijim të procedurave për të fituar këtë titull kam kryer edhe pagesat përkatëse. Ju vë në dijeni që pavarësisht se kam fituar titullin ‘Avokat’ nuk e kam ushtruar ndonjëherë këtë profesion. Bashkëlidhur të skanuar ju paraqesim konfirmimin për kryerjen e pagesës...”*

26. Kjo pagesë është llogaritur si shpenzim në analizën financiare të bere nga Komisioni.

27. Nga administrimi i deklaratave periodike vjetore është evidentuar se subjekti ka deklaruar në trung familjar babanë, nënën dhe vëllanë që nga deklarata e parë para fillimit të detyrës e deri në DPV-në e vitit 2014, përveçse në DPV-në e vitit 2008, ku subjekti deklarohet e vetme, pa pjesëtarët e tjerë të familjes.

¹¹Kontratë nr. ****, datë 16.12.1998, në dosjen e ILDKPKI-së Aneksi 4/13.

¹²Shkresë nr. ****, datë 22.8.2017, nga DPT-ja në dosjen e ILDKPKI.

¹³ Shkresë nr. **** prot., datë 5.3.2019.

27.1 Në DPV-të e viteve 2015, 2016, 2017 dhe në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi në trung familjar vetëm babanë dhe nënën. Për shkak të deklaratimit të subjektit në të njëjtin trung familjar me të vëllanë, ndër vite, Komisioni vlerësoi të shtrinte hetimin edhe duke i kërkuar informacion institucioneve kompetente¹⁴ lidhur me vëllanë H. Q.

28. Gjithashtu, Komisioni e ka pyetur subjektin, lidhur me faktin e deklaratimit në deklaratat periodike vjetore në të njëjtin trung me të vëllain, si dhe për të paraqitur dokumentacionin në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e vëllait, në kuptim të analizës financiare.

29. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar, ndër të tjera, se:

¹⁴ 1-kërkesë nr. ** prot., datë 8.1.2020, e Komisionit drejtuar shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a., për shtetasin H. Q 1/2-kthim përgjigje nr. *** prot., datë 27.1.2020, shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.; 2-kërkesë nr. *** prot., datë 8.1.2020, e Komisionit drejtuar OSHEE-së 2/1-kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.1.2020, e FSHU.-së për shtetasin H. Q; 3-kërkesë nr. ** prot., datë 8.1.2020, e Komisionit drejtuar Ministrisë së Drejtësisë 3/1-kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2020, e Ministrisë së Drejtësisë për shtetasin H. Q; 4-kërkesë nr. ** prot., datë 8.1.2020, e Komisionit drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile Tiranë; 4/1-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 22.1.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, shtetasi H.Q; 5-kërkesë nr. ** prot., datë 8.1.2020, e Komisionit drejtuar DPPPP-së Tiranë; 5/1kthim përgjigje nr. ** prot., datë 23.1.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave shtetasi H.Q; 6-kërkesë nr. ** prot., datë 8.1.2020, e Komisionit drejtuar DPSHTRr-së Tiranë; 6/1-kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.1.2020, e DPSHTRr-së Tiranë shtetasi H.Q; 7-kërkesë nr. **, datë 8.1.2020, e Komisionit drejtuar Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë; 7/1-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 17.1.2020, e Agjencisë së Trajtimit të Pronave, shtetasi H.Q; 8-kërkesë nr. ** prot., datë 8.1.2020, e Komisionit drejtuar DPT-së Tiranë; 8/1 -kthim përgjigje nr. ** prot., datë 16.1.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve mbi shtetasin H. Q; 9-kërkesë nr. ** prot., datë 8.1.2020, e Komisionit drejtuar ISSH-së Tiranë; 9/1 -kthim-përgjigje nr. ** prot., datë 16.1.2020, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, mbi shtetasin H.Q; 9/2-kthim përgjigje nr. **, prot., datë 22.1.2020, e Drejtorisë së Arkivit Rajoni Tiranë, mbi shtetasin H.Q; 10-kërkesë nr. ** prot., datë 8.1.2020, e komisionit drejtuar ASHK-së shtetasin H.Q; 10/1-kthim përgjigje nr. **, prot., datë 30.1.2020, e ASHK-së; 10/2-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 30.1.2020 e ASHK-së Peqin shtetasin H.Q; 10/3-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 30.1.2020, e ASHK-së Librazhd shtetasin H. Q; 10/4-kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 30.1.2020, e ASHK-së Pukë shtetasin H. Q; 10/5- kthim përgjigje nr. ** prot., datë 30.1.2020, e ASHK-së Has shtetasin H.Q; 10/6-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 30.1.2020, e ASHK-së Tropojë shtetasin H.Q; 10/7-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 30.1.2020, e ASHK-së Kukës; 10/8-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 17.2.2020, e ASHK-së Vlorë për shtetasin H. Q; 10/9-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 17.2.2020, e ASHK-së Sarandë për shtetasin H.Q; 10/10-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 17.2.2020, e ASHK-së Durrës për shtetasin H. Q; 10/11-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 21.2.2020 ASHK Kavajë për shtetasin H.Q; 10/12-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 21.2.2020 ASHK-së Përmet për shtetasin H.Q; 10/13-kthim përgjigje nr. *** prot., datë 31.01.2020 ASHK-së Mirditë, për shtetasin H. Q 10/14-kthim përgjigje nr. *** prot., datë 31.1.2020, ASHK-së Korçë për shtetasin H. Q 10/15-kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 3.2.2020 ,ASHK-së Lezhë për shtetasin H.Q 10/16-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 3.2.2020, ASHK-së Dibër; 10/17-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 5.2.2020, ASHK-së Kurbin për shtetasin H.Q; 10/18-kthim përgjigje nr. *** prot., datë 5.2.2020, ASHK-së Devoll; 10/19-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 11.2.2020, ASHK-së Malësi e Madhe për shtetasin H.Q; 10/20-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 11.2.2020, ASHK-së Lushnjë për shtetasin H. Q; 10/21-kthim përgjigje ** prot., datë 11.2.2020, ASHK-së Bulqizë; 10/22-kthim përgjigje nr. ***, datë 11.2.2020, ASHK-së Berat për shtetasin H. Q; 10/23 -kthim përgjigje nr. **, datë 31.1.2020, ASHK-së Tirana Rurale 1 për shtetasin H.Q; 10/24-kthim përgjigje nr. ** prot., datë 5.2.2020, ASHK-së Tirana Rurale 2 për shtetasin H.Q; 10/25- kthim përgjigje nr. ** prot., datë 5.2.2020, ASHK-së Tirana -Veri për shtetasin H. Q; 10/26-kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.2.2020, ASHK-së Tirana jug për shtetasin H.Q; 10/27-kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.2.2020, ASHK-së Kamzës-Vorë; 10/28- kthim përgjigjeje nr. *** prot, datë 6.4.2020, ASHK-së Gramsh; 10/29-kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.4.2020, ASHK-së Krujë; 10/30-kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 11.2.2020, ASHK-së Shkodër për shtetasin H. Q; 11 kërkesë për informacion nr. **prot., datë 8.1.2020, e Komisionit drejtuar bankave; 11/1 kthim përgjigjeje nr. **, datë 13.1.2020, e “Raiffeisen Bank” për shtetasin H.Q; 11/2 kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 15.1.2020, e “Tirana Bank” për shtetasin H.Q; 11/3 kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 20.1.2020, e “Union Bank” për shtetasin H.Q 11/4 kthim përgjigje nr. *** prot, datë 11.01.2020 UBA për shtetasin H. Q; 11/5 kthim përgjigje nr. ** prot., datë 16.1.2020, ABI Bank për shtetasin H.Q; 11/6 kthim përgjigjeje nr. **prot., datë 16.1.2020, Tirana Factoring&lease për shtetasin H.Q; 11/7-kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 16.1.2020, e “Intesa Sanpaolo Bank”; për shtetasin H.Q 11/8 kthim përgjigje nr. **prot., datë 16.1.2020, e “Alpha Bank” për shtetasin H.Q; 11/9- kthim përgjigje nr. **prot, datë 16.01.2020 Landeslease shtetasin H.Q; 11/10 kthim përgjigje nr. ** prot, datë 16.1.2020, Banka Shqipërisë-H.Q11/11 kthim përgjigje nr. ** prot., datë 16.1.2020 “OTP Bank” për shtetasin H.Q 11/12-kthim përgjigje nr. **prot., datë 21.1.2020 AKInvest për shtetasin H.Q; 11/13-kthim përgjigje nr. **prot, datë 21.1.2020, e “Albania Leasing” për shtetasin H.Q; 11/14 kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 21.1.2020, e Fondit Besa për shtetasin H.Q; 11/15 kthim përgjigje nr. *** prot, datë 21.1.2020 Unioni Financiar Tirana, për shtetasin H. Q; 11/16 kthim përgjigjeje nr. ** prot, datë 21.01.2020 Procredit Bank për shtetasin H. Q 11/17 kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 21.1.2020, Credins Invest; 11/18 kthim përgjigjeje nr.** prot., datë 21.1.2020, Raiffeisen Invest për shtetasin H.Q; 11/19 kthim përgjigje nr. ** prot, datë 23.1.2020, NOA për shtetasin H.Q; 11/20 kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.1.2020, Porche për shtetasin H.Q;11/21 kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 23.1.2020, Raiffeisen Leasing për shtetasin H. Q; 11/22 kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.2.2020, “Credins Bank” për shtetasin H.Q 11/23-kthim përgjigje nr. *** prot, datë 03.02.2020 B.K. për shtetasin H. Q.

*“...prindërit e mi I dhe S. Q kanë në bashkëpronësi dy apartamente, shpjeguar si me lart. Pas ndarjes nga jeta të gjyshërve të mi, në vitin 2004, prindërit e mi kaluan të jetojnë në ap. *, së bashku me mua (apartament dy dhomë e kuzhinë). Për arsye akomodimi dhe të moshës, vëllai 25 vjeç (në vitin 2004) qëndronte në apartamentin nr. *. Shpenzimet jetësore i ka mbuluar vetë. Në këtë apartament jeton dhe sot e kësaj dite, së bashku me familjen e tij, bashkëshorten dhe vajzën”.*

30. Subjekti ka paraqitur, në përgjigje të pyetësorit 2, një certifikatë vdekjeje nga zyra e gjendjes civile¹⁵, në të cilën vërtetohet se shtetasi M. Q është ndarë nga jeta në datën 5.9.2004 dhe gjendja e tij civile ka qenë i ve.

31. Komisioni ka administruar shkresën kthim përgjigje¹⁶ të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, nga e cila konfirmohet se shtetasi H. Q figuron i regjistruar banor në zyrën e gjendjes civile në Njësinë Bashkiake nr. *, njësia administrative Tiranë dhe ka lidhur martesë me shtetasen I. Q të cilët janë ndarë në familje më vete.

32. Pas kryerjes së hetimit, trupi gjykues trupi nuk konstatoi problematika apo dyshime në lidhje me pasurinë e vëllait të subjektit të rivlerësimit.

33. Komisioni ka evidentuar se në DPV-të për vitet 2011 dhe 2012, subjekti ka deklaruar (në rubrikën e të dhënave konfidenciale) se babai dhe nëna i kanë dhuruar për ditëlindje shuma *cash*, përkatësisht, për vitin 2011, vlerën 50.000 lekë dhe për vitin 2012, vlerën 100.000 lekë.

34. Komisioni ka pyetur subjektin në pyetësorin 2 në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të dhuruara nga prindërit si persona të tjerë të lidhur, bazuar në pikën 14 të nenit 3, si dhe pikën 432 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

35. Në përgjigje të pyetësorit 2, subjekti ka sqaruar se:

“...Shuma e dhuruar nga prindërit në datën 16.3.2011 është 50.000 lekë. Burimi i ligjshëm i kësaj dhurate është kursimi i kësaj shume nga pagat e tyre (bashkëlidhur deklarata noteriale e skanuar, pagat mujore të tyre)”.

“...Shuma e dhuruar nga prindërit në datën 16.3.2012, me rastin e 30- vjetorit të ditëlindjes është 100.000 lekë. Burimi i ligjshëm i kësaj dhurate është kursimi i kësaj shume nga pagat e tyre (bashkëlidhur deklarata noteriale e skanuar, pagat mujore te tyre)”.

36. Komisioni përgatiti analizën financiare për mundësinë e prindërve të subjektit për të kursyer shumën e dhënë dhuratë prej 150,000 lekësh në periudhën 2011- 2012¹⁷, nga ku rezultoi se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare për t’i dhënë dhuratë subjektit në periudhën 2011- 2012.

37. Nga administrimi i informacionit të ardhur nga BKT¹⁸, është evidentuar se personat e lidhur me subjektin, babai dhe nëna kanë hapur një llogari depozite me afat 6-mujor, në datën 13.2.2019, ku kanë depozituar shumën prej 10.000 euro.

38. Komisioni ka hetuar lidhur me këtë llogari depozite, si dhe ka pyetur subjektin¹⁹ në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës bankare nga prindërit si persona të tjerë të

¹⁵Certifikatë nga Zyra e Gjendjes Civile nr. ***, datë 5.4.2019, dërguar me pyetësorin 2.

¹⁶Shkresa nr. *** prot., datë 17.1.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

¹⁷ Analiza financiare mbi të ardhurat e prindërve nga pagat e përfituara në periudhën 2009-2011 dhe gjendjen pas huas së dhënë subjektit nga prindërit në shumën 3,000 euro në vitin 2009.

¹⁸Shkresa nr. *** prot., datë 5.3.2019, nga BKT-ja.

¹⁹ Pyetësori 2.

lidhur, bazuar në pikën 14 të nenit 3, si dhe në pikën 432, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

39. Në përgjigje të pyetësorit 2 subjekti ka sqaruar, ndër të tjera, se: “...prindërit e mi kanë pasur një llogari të hershme në “Raiffeisen Bank”. Kanë kryer veprime në këtë llogari duke bërë depozitim të kursimeve të tyre here pas here.” “...meqenëse kjo bankë mbante 2 euro në muaj komision, ishte larg shtëpisë, duke dashur që të përfshihej në llogari si mbajtëse e dytë edhe S. Q (për lehtësi tërheqje, prindërit tashmë janë në pension pleqërie) vendosën të mbyllin këtë llogari në ‘Raiffeisen Bank’, nga kjo shumë 6500 euro tërhequr nga ‘Raiffeisen Bank’ në datën 13.2.2019, si dhe 3.500 euro tërhequr në ‘Raiffeisen Bank’ në datën 12.2.2019, në tërësinë e tyre 10.000 euro, janë depozituar në datën 13.2.2019, në BKT depozitë me afat 6-mujor”.

40. Subjekti ka bashkëlidhur në përgjigje të pyetësorit 2 mandat tërheqjeje nr. ***, datë 11.2.2019, nga llogaria e shtetasit I.Q në “Raiffeisen Bank”, shumën 3.500 euro; mandat tërheqjeje nr. ***, datë 12.2.2019, nga llogaria e shtetasit I.Q në “Raiffeisen Bank”, shumën 3,500 euro; mandat tërheqjeje nr. ***, datë 13.2.2019, nga llogaria e shtetasit I .Q në “Raiffeisen Bank”, shumën 7,430 euro.

41. Nga hetimi i Komisionit, në “Raiffeisen Bank”²⁰ kanë rezultuar transaksione të kryera nga personi i lidhur, në llogarinë e depozitës.

42. Komisioni, në vijim i ka kërkuar informacion kësaj banke²¹ për transaksionet e kryera nga personi i lidhur ku me përgjigjen datë 14.4.2020²², “Raiffeisen Bank” ka informuar se personi i lidhur ka tërhequr fondet dhe ka mbyllur llogarinë në vitin 2019.

43. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se personi i lidhur I. Q kishte kryer tërheqje në shumën 14,430 euro në “Raiffeisen Bank”, në datat 11.2.2019, 12.2.2019 dhe 13.2.2019 dhe ka çelur në datën 13.2.2019, depozitën në shumën 10.000 euro në BKT.

Trupi gjykues nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë llogari dhe historikun e saj.

Konkluzion mbi vlerësimin e pasurisë

44. Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara dhe dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, mori në shqyrtim pretendimet dhe provat e paraqitura, arriti në përfundimin se në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

45. Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve në datën e investimit të pasurive në vlerën prej -575.878 lekësh, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Mungesa e likuiditeteve nuk ka ndikuar në sjelljen e subjektit të rivlerësimit në drejtim të deklarimit të pasurive në përputhje me detyrimet ligjore.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

46. Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, DSIK-ja në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin e figurës, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur në Komision raportin nr. ***prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së, nr. **, datë

²⁰Shkresa kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.2.2019.

²¹ Kërkesë datë 9.4.2020, drejtuar “Raiffeisen Bank” për transaksionet e kryera nga I. Q. pas datës 15.1.2019.

²² Shkresa kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.4.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

1.3.2019, ku rezulton se formulari i deklarimit është i plotë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.

47. Nga informacioni i ardhur nga institucionet verifikuese rezulton se: Subjekti i rivlerësimit i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njejtat gjeneralitete si ato të deklaruara në Deklaratën për kontrollin e figurës. Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar. Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi.

Konkluzioni për kontrollin e figurës

48. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

48.1 Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit znj. Anisa Qilimi ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

49. Vlerësimi profesional është kryer për subjektin e rivlerësimit nga institucioni ndihmës Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

50. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit konstatohet si vijon:

51. Formulari vetëdeklarimit paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

52. Përvoja profesionale: Subjekti, në periudhën 2007 – 2008, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë (stazh profesional). Në vijim, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe për pak kohë si prokuror e komanduar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

53. Detyrat e kryera tre vitet e fundit dhe të dhënat statistikore: Subjekti i rivlerësimit, për tri vitet e fundit, ka deklaruar se ka punuar në fushën e drejtësisë penale, duke specifikuar kryerjen e detyrave në hetimin dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq për veprat penale në kompetencë të Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë (si prokuror i komanduar).

54. Për sa i përket numrit të çështjeve penale të përfunduara në tre vitet e fundit, subjekti i rivlerësimit deklaroi 127 (njëqind e njëzet e shtatë) procedime penale dhe 82 (tetëdhjetë e dy) materiale kallëzuese. Për sa i përket numrit të çështjeve të mbartura, subjekti i rivlerësimit deklaroi 48 (dyzet e tetë) procedime penale.

55. Trajnimet në tre vitet e fundit: Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pjesëmarrjen në pesë aktivitete trajnuese, në kuadër të ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

56. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit janë:

57. Vendim mosfillimi, marrë në kuadër të kallëzimit penal nr.***/2016, me kallëzues shtetasin F. Sh.

58. Vendim zgjatje afati, marrë në kuadër të procedimit pasuror nr. **, datë 16.4.2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

59. Konkluzione përfundimtare, marrë në kuadër të procedimit penal nr. ***/2012, për veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, me të pandehur shtetasen A. H.

60. Përshkrimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short

60.1 Dosja 1. Kallëzimi penal nr.***, datë regjistrimi 2.2.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Objekti i shortit: dokumenti ligjor - vendim “për mosfillimin e procedimit penal”, datë 24.3.2016.

60.1.1 Nga policia gjyqësore është referuar materiali kallëzues nr. **, datë 2.2.2016, janë kryer një sërë veprimesh hetimore të natyrës verifikuese, janë pyetur persona që kanë treguar rrethana të hetimit, janë kërkuar dokumente dhe pasi janë analizuar njëri pas tjetrit në frymën e dispozitave ligjore, ka rezultuar se fakti për të cilin është bërë kallëzim penal, nuk përmban elemente të figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal “falsifikim i dokumenteve” duke u shprehur se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar në germën “ç”, të nenit 290, si dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale.

60.1.2 Dokumenti ligjor “vendim” është i strukturuar dhe i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese-arsyetuese dhe dispozitivi. Nga përmbajtja e tij konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkimit. Teksti është i qartë dhe i kuptueshëm. Akti është i arsyetuar. Vendimi i është njoftuar referuesit, pra, kallëzuesit dhe personit ndaj të cilit është bërë kallëzim në kuptim të ligjit. Vendimi i mosfillimit që lidhet me procedimin penal është marrë pothuajse²³ brenda afatit 30-ditor, parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “*Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”* i ndryshuar, i Prokurorit të Përgjithshëm.

60.1.3 Lidhur me këtë procedim, Komisioni pasi administroi vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit, shqyrtoi dokumentacionin që lidhej me procedimin dhe pasi e analizoi, kërkoi shpjegimet e subjektit për sa vijon:

Në këtë procedim, subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se falsifikimi është një vepër penale që nuk ndiqet me ankim, është mjaftuar me deklarimin e shtetasve se akti nuk është falsifikuar, duke mos hetuar më thellë. Në këtë mënyrë, subjekti i rivlerësimit, duket se nuk ka hetuar, duke mos ushtruar funksionin kushtetues.

60.1.4 Subjekti lidhur me gjetjet e Komisionit, shpjegoi:

*“Në vlerësimin e materialit kallëzues nr. **, datë 2.2.2016, veprimet verifikuese kanë qenë të plota: është pyetur kallëzuesi P. S, i kallëzuarit A.D, është pyetur dy herë shtetasja A S, si dhe është shkëmbyer korrespondencë me Gjykatën e Lartë.*

²³ Vonesa disaditore në vendimmarrje shpjegohet me kryerjen e një sërë veprimeve hetimore të vendosura për tu kryer në kuadër të këtij materiali kallëzues dhe për shkak të natyrës së këtyre veprimeve.

Vetë e interesuara, shtetasja A. S konfirmon nënshkrimin në rekurs, pranon se ka qenë prezent në përpilimin e rekursit dhe konfirmon se rekursi është bërë për shkak se nuk ka qenë dakord me vendimin e Gjykatës së Apelit.

Mbështetur në sa më sipër është konkluduar për mosfillimin e procedimit penal, pasi vullneti i brendshëm i shtetasës A. S përputhet me vullnetin e jashtëm të saj për të ushtruar rekurs ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit dhe nuk ka fakt penal për të proceduar me regjistrimin e çështjes penale. Rekursi është një akt individual i saj, në mbrojtje të interesave të saj ligjore dhe për sa kohë kjo e fundit konfirmon nënshkrimin, nuk ka vend për hetim të mëtejshëm.

Vendimi i mosfillimit i është komunikuar kallëzuesit dhe ka pasur të drejtën e ankimit sipas ligjit, ndërkohë që ky vendim sot e kësaj dite është ende në fuqi. Vlerësoj se materiali kallëzues është trajtuar me seriozitet brenda kornizës ligjore në ushtrim të funksionit kushtetues të prokurores”.

60.1.5 Komisioni analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe arrin në konkluzionin se nuk u konstatuan të dhëna apo fakte konkrete lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit në këtë procedim.

60.2. Dosja 2. Procedimi penal nr. **, regjistruar në datën 17.9.2014 për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/4 të Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.

60.2.1 Objekti i shortit: dokumenti ligjor-vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. ***të vitit 2014” datë 17.9.2014. Ky procedim penal nr. *** i vitit 2014 ishte regjistruar në ngarkim të shtetasit A.Ç për veprën penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor” mbi bazën e referimit të bërë nga Komisariati i Policisë Krujë në datën 4.7.2014.

60.2.2 Pasi janë kryer veprimet hetimore është analizuar akti i ekspertimit autoteknik, janë analizuar provat në harmoni me njëra-tjetrën dhe subjekti i rivlerësimit ka arritur në konkluzionin se procedimi penal duhet të pushohet sepse nuk ka vend për nisje duke e arsyetuar atë.

60.2.3 Me vendimin datë 17.9.2014, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në bazë të germës “dh”, të pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur:

- pushimin e çështjes penale nr. ***/2014 për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/4 i Kodit Penal;
- të njoftoj me këtë vendim personat e interesuar dhe mbrojtësit ligjor;
- kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë brenda afatit ligjor.

60.2.4 Dokumenti ligjor “vendim” është i strukturuar dhe i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese-arsyetuese dhe dispozitivi. Baza ligjore e vendimit të pushimit të procedimit penal germa “dh”, e pikës 1, të nenit 328 është identifikuar drejt. Për shkak të natyrës së veprës penale dhe viktimave të përfshira në të, rezulton se vendimi i është njoftuar të dëmtuarit nga vepra penale dhe të hetuarit në datën 17.9.2014. Rezultati i hetimit i është njoftuar edhe Komisarariatit të Policisë Krujë dhe palëve të përfshira në këtë procedim penal.

60.2.5 Lidhur me këtë procedim, Komisioni pasi administroi vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit, shqyrtoi dokumentacionin që lidhej me procedimin dhe pasi e analizoi, kërkoi shpjegimet e subjektit për sa vijon:

- Së pari: në këtë çështje është caktuar një ekspert nga lista e ekspertëve privatë, pa iu drejtuar autoriteteve policore shtetërore. Duket se një vendim i tillë i lë mundësi shtetasit nën hetim të kontaktojë me ekspertin privat për efekt vendimmarrjeje.
 - Së dyti: duke qenë se ngjarja ka qenë relativisht e rendë dhe duke pasur si pasojë dy viktima, prokurori duhej detyrimisht të caktonte një grup ekspertesh për të nxjerrë konkluzion në lidhje me ekspertimin.
 - Së treti: nga aktet e dosjes nuk rezulton t'i jetë njoftuar vendimi palës së dëmtuar, si detyrim i prokurorit (është njoftuar vetëm mbrojtësi dhe nuk është marrë konfirmimi nëse realisht kanë marrë dijeni në lidhje me rastin), duke i mohuar për rrjedhojë të drejtën e ankimit kundër vendimit të pushimit.
 - Së katërti: të dëmtuarit nuk janë njohur me aktin e ekspertimit duke mos iu dhënë mundësinë e ankimit të këtij akti/apo nuk janë njohur me ekspertin e caktuar duke mos iu dhënë mundësi për të parashtruar kërkesa për përjashtim të ekspertit.
- Së pesti: i hetuari A. Ç., nuk ka pasur dokumentacion të rregullt të mjetit.

Subjekti, lidhur me gjetjet e Komisionit, shpjegoi se:

60.2.6 Lidhur me gjetjen e parë të Komisionit, se në këtë çështje është caktuar një ekspert nga lista e ekspertëve privatë, pa iu drejtuar autoriteteve policore shtetërore, subjekti ka paraqitur bazën ligjore ku organi procedues bazohet në caktimin e ekspertit, pika 1, e nenit 179, të Kodit të Procedurës Penale dhe pika 3, e nenit 294, të Kodit të Procedurës Penale ku parashikohet se *“Caktimi i ekspertit bëhet duke e zgjedhur atë ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse”* duke konkluduar se qëndrimi i organit procedues, shërbimeve të policisë gjyqësore në kryerjen e veprimeve të para hetimore është i mbështetur në ligj, eksperti autoteknik është nga lista e ekspertëve privatë dhe me njohuri të posaçme në degë.

60.2.7 Lidhur me gjetjen e dytë të Komisionit se subjekti duhej detyrimisht të caktonte një grup ekspertesh për të nxjerrë konkluzion në lidhje me ekspertimin, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“...organi i prokurorisë heton faktin penal dhe kryen veprime hetimore dhe procedurale në drejtim të provueshmërisë së veprës ndaj autorit të veprës penale. Mekanizmi i aksidentit rrugor ishte deri diku i lexueshëm, që gjatë analizës së vendngjarjes. Ngjarja paraqitej e rendë për shkak të pasojës së ardhur, por në vetvete ky ekspertim nuk përfshinte kërkime dhe vlerësime shumë komplekse apo në disa degë, siç është dhe kërkesa e ligjit sipas nenit 179, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale.”*

60.2.8 Lidhur me gjetjen e tretë të Komisionit se nga aktet e dosjes nuk rezulton t'i jetë njoftuar vendimi palës së dëmtuar, si detyrim i prokurorit, duke i mohuar për rrjedhojë të drejtën e ankimit kundër vendimit të pushimit, subjekti ka sqaruar se: *“Njoftimet janë bërë me shkresë. Nuk kam qenë në dijeni të marrjes ose jo të konfirmimit. Në pikën dy të dispozitivit të vendimit, parashikohet e drejta për t'u njohur me vendimin e palëve të interesuara. Në çdo moment kushdo që ka apo ka pasur interes mund të kërkonte dhe merrte kopje të vendimit. E drejta për ankim fillon nga momenti i marrjes dijeni dhe në asnjë rast nuk mohohet e drejta për ankim ndaj vendimit të pushimit.”*

60.2.9 Në lidhje me gjetjen e katërt të Komisionit se të dëmtuarit në këtë procedim nuk janë njohur me ekspertin e caktuar, duke mos iu dhënë mundësi për të parashtruar kërkesa për përjashtim të ekspertit, subjekti ka sqaruar se: *“Sipas nenit 179, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale vendimi i organit procedues për caktimin e ekspertit i njoftohet të pandehurit ose mbrojtësit të tij, duke i bërë të ditur se ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e ekspertit, të propozojë ekspertë të tjerë, të marrë pjesë vetë në ekspertim dhe të parashtrtojë pyetje për ekspertin”.*

60.2.10 Në lidhje me gjetjen e pestë të Komisionit se i hetuari në këtë procedim A. Ç., nuk ka pasur dokumentacion të rregullt të mjetit, subjekti ka shpjeguar se: “*dokumentacioni i parregullt i mjetit nuk passjell përgjegjësi penale*”.

60.2.11 Komisioni analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe arrin në konkluzionin se nuk u konstatuan të dhëna apo fakte konkrete lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit në këtë procedim.

60.3 Dosja 3. Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 8.11.2014 për veprën penale ‘shpërdorim i detyrës’ dhe “përkrahje e autorit të krimit”, parashikuar nga nenet 248 dhe 302 të Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, mbi bazën e materialit të përcjellë nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm Durrës, objekti i shortit: dokumenti ligjor-vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2014”, datë 10.2.2015.

60.3.1 Nga tërësia e veprimeve hetimore, lidhur me këtë procedim penal dhe pas analizimit të rrethanave dhe provave të mbledhura, organi i akuzës ka arritur në përfundimin se fakti nuk përbën vepër penale.

60.3.2 Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, prokurori i çështjes qysh prej datës 9.12.2014 ka konkluduar se procedimi penal nr. *** i vitit 2014, është pushuar me argumentin se fakti nuk përbën vepër penale.

60.3.3 Me vendimin datë 16.11.2015, në bazë të germës “b”, të pikës 1, të nenit 328 dhe të nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. *** për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe “përkrahje autorit të krimit”, parashikuar nga nenet 248 dhe 302 të Kodit Penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Të njoftohen me këtë vendim personat e interesuar, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe, konkretisht, Drejtorinë e Standardeve Profesionale Tiranë, si edhe në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës. Subjekti i rivlerësimit në këtë çështje ka qenë prokurori zëvendësues, pas delegimit të prokurorit të parë në një Prokurori tjetër.

60.3.4 Dokumenti ligjor “vendim” është i strukturuar dhe i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi. Nga përmbajtja e aktit procedural “vendim pushimi”, konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Teksti është mëse i qartë dhe i kuptueshëm.

60.3.5 Vendimi është ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese-argumentuese dhe përfundon me dispozitivin për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Akti përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Rezulton se në vendim pasqyrohen rrethanat e faktit penal, argumentimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit pasqyron veprimet hetimore në vijimësi dhe përputhet me veprën penale për të cilën prokurori ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal.

60.3.6 Komisioni pasi administroi vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit, shqyrtoi dokumentacionin që lidhet me procedimin dhe pasi e analizoi, kërkoi shpjegimet e subjektit për sa duket se qëndrimi i prokurorit ka qenë neglizhent:

- për sa nuk është hetuar në lidhje me arsyen e takimit të punonjësit të policisë së dyshuar me autorët e dyshuar të krimit;
- duke qenë se autorët e dyshuar për ngjarjen e datës 12.6.2014, kanë qenë në kërkim nga policia me kartelë rozë nuk është verifikuar çfarë aksesit ka pasur në këtë informacion punonjësi i policisë, për të nxjerrë në pah nëse ka kryer veprime aktive për të informuar në lidhje me shpalljen e tyre në kërkim;
- në relacionin e datës 15.10.2014, oficeri i policisë gjyqësore F.Z, ka sugjeruar në përfundim të hetimeve procedimin e të dyshuarit M. D., duke treguar se “duke qenë në detyrë ky

punonjës mund të ndikojë edhe për raste të tjera’’. Për më tepër, në relacionin e policisë së shtetit në mbështetje të neneve 248 dhe 302 të Kodit të Procedurës Penale, i është kërkuar prokurorisë si e domosdoshme që hetimi i shtetasit M. D., të vijonte me masë sigurimi arrest në burg, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale, pasi qenia e tij në punë apo në gjendje të lirë do të rrezikonte objektivitetin dhe mbarëvajtjen e hetimeve, f. **e dosjes.

60.3.7 Për sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal dhe procedural, që e kanë çuar në një vendimmartje të nxituar dhe joobjektive. Veprimet hetimore nuk kanë qenë shteruese për të përcaktuar përgjegjësinë dhe faktin penal.

60.3.8 Subjekti, lidhur me gjetjet e Komisionit, shpjegoi se: “...*relacioni i oficerit mban datën 15.10.2015²⁴ dhe i është adresuar prokurorit të parë të çështjes. Unë, subjekti rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi jam caktuar për ndjekje të mëtejshme në këtë procedim penal në datën 9.12.2015²⁵. Pas gati dy muajsh nga relacioni i OPGJ-së, pasi kam marrë aktet e procedimit penal jam njohur me përmbajtjen e relacionit. Në hetim, në këtë periudhë gati dymujore, nuk dokumentoheshin takime apo veprime të tjera, të cilat mund të rrezikonin objektivitetin apo mbarëvajtjen e hetimeve nga inspektori i rendit. Relacioni i oficerit të policisë sipas pikës 1, të nenit 327, të Kodit të Procedurës Penale është relacion sugjerues. Për më tepër në këtë periudhë dymujore nuk kishte asnjë të dhënë të azhurnuar për rendimin e pozitës procedurale të inspektorit të policisë, z. M. D, të cilat të përligjin kërkesën për caktim mase ‘arrest me burg’, relacioni nuk paraqitet më aktual. Sipas paragrafit 1, të nenit 230, të Kodit të Procedurës Penale ‘arrest në burg’ mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit. Për më tepër vlerësoj dhe çmoj që duhet pasur shumë kujdes procedural kur godet figurën e autoritetit policor, duke kërkuar masa të tilla ekstreme. Produkti i hetimit të procedimit penal nr. **/2014 ishte i qartë. Veprimet hetimore të kryera ishin të plota për të konkluduar për zgjidhjen ligjore të çështjes”.*

60.3.9 Komisioni analizoi shpjegimet e dhëna dhe konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë se prej saj janë kryer veprime të plota hetimore për të nxjerrë përgjegjësinë penale të autorit të dyshuar dhe se qëndrimi i prokurores ka qenë neglizhent, duke mos hetuar në lidhje me arsyen e takimit të punonjësit të policisë me autorët e dyshuar të krimit.

60.3.10 Për më tepër, Komisioni vlerëson dhe çmon që figura e autoritetit policor nuk duhet të shërbejë si arsye për mos hetim shterues nga ana e subjektit të rivlerësimit, në këtë rast, për sa të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit.

Në konkluzion, trupi gjyqës vendosi që veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi, për procedimin penal nr. */2014 duhet të jetë objekt i një hetimi të plotë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për të përcaktuar nëse në këtë procedim penal janë kryer shkelje disiplinore nga subjekti i rivlerësimit znj. Anisa Qilimi.**

60.4 Dosja 4. Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 24.10.2014, në emër të personave të cilit i atribuohet vepra penale E. H dhe L. Sh, hetuar për veprën penale “mashttrim” e parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë. Objekti i shortit: dokumenti ligjor - kërkesë “për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014”, datë 10.12.2014, përgatitur nga subjekti i rivlerësimit.

²⁴ Viti është lajthim pasi referuar dosjes penale që lidhet me këtë procedim ky relacion i referohet datës 15.10.2014

²⁵ Viti 2015 është lajthim i subjektit në sqarim pasi referuar dosjes subjekti është caktuar për ndjekje të mëtejshme të rastit me vendimin për zëvendësim prokurori, datë 9.12.2014, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.

60.4.1 Ky procedim si fillim është regjistruar në Gjilan, Kosovë pasi vepra penale është kryer në këtë vend. Më pas, procedimi është transferuar në Prokurorinë kompetente pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë në ngarkim të shtetasve shqiptarë E. M dhe L.Sh, banuese në Fushë-Krujë, me shkresën nr. ***, datë 10.10.2014, të Ministrisë së Drejtësisë dhe mbi bazën e kërkesës së autoriteteve të drejtësisë së Kosovës, përkatësisht të Prokurorisë Themelore. Me mbërritjen e materialit referues të policisë gjyqësore, prokurori i ngarkuar me hetimin e çështjes, prokurorja Anisa Qilimi, në mbështetje të neneve 287 dhe 315 të Kodit të Procedurës Penale ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, në datën 24.10.2014.

60.4.2 Procedimi penal është regjistruar për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/1-25e i Kodit Penal në ngarkim të shtetasve E. M dhe L. Sh. Prokurori ka disponuar me urdhër “Për delegimin dhe kryerjen e veprimeve hetimore” më 24.10.2014. Subjekti i rivlerësimit, në çmim të të dhënave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, më 21.11.2014, bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”.

60.4.3 Vendimi i është njoftuar të pandehurit, por nuk figuron në akt data e njoftimit. Pasi ka marrë në pyetje shtetasit L.Sh dhe E.M, në cilësinë e të pandehurit dhe njohjen e tyre me materialet e çështjes, në datën 10.12.2014, ka marrë vendimin për dërgimin e çështjes për gjykim. Vendimi është marrë konform nenit 327/2 të Kodit të Procedurës Penale. Në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit, prokurorja Anisa Qilimi, me “kërkesë për gjykim të procedimit penal nr. ***, viti 2014”, ka paraqitur për gjykim procedimin penal në ngarkim të të pandehurve L. Sh dhe E.M, para Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.

60.4.5 Dokumenti ligjor “kërkesë” është i strukturuar dhe përmban të dhënat dhe elementet e kërkuara nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale. Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm, konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe përmbajnë referenca ligjore. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri dhe teksti paraqitet i kuptueshëm.

60.4.6 Komisioni arrin në konkluzionin se nuk u konstatuan të dhëna apo fakte konkrete lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit në këtë procedim.

60.5 Dosja 5. Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 28.12.2014, me të pandehur z. M. D, i akuzuar për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike” të parashikuar nga neni 137/1 të Kodit Penal. Objekti i shortit: dokumenti ligjor - kërkesë “për gjykimin e procedimit penal nr.**, viti 2014”, datë 28.12.2014, përgatitur nga subjekt rivlerësimi.

60.5.1 Pas një analize të hollësishme të provave të marra gjatë hetimit paraprak të këtij procedimi penal dhe pas çmuarjes së tyre me objektivitet, në lidhje me njëra-tjetrën, ka rezultuar e provuar se ka të dhëna të mjaftueshme që të krijojnë bindjen se personi nën hetim, z. M.D, me veprimet e tij aktive, të kundraligjshme, të kryera me dashje direkte, ka konsumuar plotësisht elementet e veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike”, të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal. Subjekti, në datën 28.12.2014, ka paraqitur në gjykatë njëkohësisht kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj të pandehurit, z. M. D dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “arrest me burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale si edhe gjykimin e drejtpërdrejtë të çështjes penale në ngarkim të tij.

60.5.2 Në kërkesë argumentohen shkaqet dhe arsyet ligjore të vleftësimit të ligjshëm të arrestit në flagrancë, arsyetohen nevojat e sigurisë në rastin konkret për caktimin ndaj të pandehurit të masës së sigurimit arrest me burg, si dhe arsyetohet fakti se janë kushtet sipas nenit 400 të

Kodit të Procedurës Penale për gjykimin e drejtpërdrejtë. Gjithashtu, në datën 28.12.2014, konform nenit 327/2 të Kodit të Procedurës Penale është marrë vendimi për “dërgimin e çështjes penale për gjykim”. Subjekti i rivlerësimit, në çmim të të dhënave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, në datën 28.12.2014, bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale ka konkluduar në vendimmarrjen “për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”.

60.5.3 Me këtë akt shtetasi M. D është marrë i pandehur për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137 e Kodit Penal. Në vendimin për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës ka rezultuar se të pandehurit i është atribuar e njëjta akuzë me të cilin është regjistruar procedimi penal. Vendimi i është njoftuar të pandehurit, por nuk figuron në akt data e njoftimit. Në mbështetje të nenit 400 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit, me “kërkesë për gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. *** viti 2014”, ka paraqitur për gjykim të drejtpërdrejtë procedimin penal në ngarkim të të pandehurit M.D, para Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.

60.5.4 Dokumenti ligjor “kërkesë” është i strukturuar dhe përmban të dhënat dhe elementet e kërkuara nga neni 400 i Kodit të Procedurës Penale. Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm, konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta, përmbajnë referenca ligjore. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri dhe teksti paraqitet i kuptueshëm.

60.5.5. Komisioni arrin në konkluzionin se nuk u konstatuan të dhëna apo fakte konkrete lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit në këtë procedim.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE

61. Nga verifikimi i të dhënave nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, si dhe të Burimeve Arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se subjekti Anisa Qilimi:

61.1 Nuk ka të dhëna apo indice të ardhura nga agjencitë ligj zbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.

61.2 Nuk ka të dhëna të dokumentuara të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm. Nuk rezulton të ketë procedim penal të regjistruar në emër të subjektit

61.3 Sektori Protokoll-Arkiv në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. ** prot., datë 28.9.2019, bën me dije se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme, nuk rezulton se ka çështje apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, në mënyrë manuale, për periudhën viti 2006 – 2018, rezulton se ekziston një ankesë: praktika nr. **, e vitit 2011 nga shtetasi A.V.

61.4 Pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, ka të dhëna për vlerësimin e punës së këtij prokurore, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar, si dhe Urdhrin nr. ***, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve” ajo është vlerësuar pozitivisht.

Njohuritë ligjore

61.5 Subjekti i rivlerësimit tregon korrektësi në zbatimin të ligjit. Në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar drejt normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet.

61.6 Aktet janë përgatitur, në respektim të dispozitave procedurale penale dhe Urdhrit Nr.174 datë 05.09.2003 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore” dhe janë administruar në sekretarinë e prokurorisë, në respektim të plotë të Urdhrit. Rezulton se qëndrimet e prokurores në të gjitha rastet, janë mbështetur nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë dhe Krujë.

Arsyetimi ligjor

61.7 Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej saj janë të kuptueshme. Nga pikëpamja gjuhësore, ka respektuar rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsytimit të aktit të përgatitur prej saj. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Në përmbajtjen e akteve procedurale rezulton se formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori. Rezulton se konkluzioni i prokurores, në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf.

61.8 Subjekti i rivlerësimit ka analizuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e caktimit të dënimit. Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton në mënyrë rigoroze standardin e procesit të rregullt ligjor.

Aftësitë organizative

61.9 Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior dhe cilësor në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, ka rezultuar se subjekti ka përballuar ngarkesën e punës, me eficiencë dhe cilësi në hartimin e akteve procedurale. Subjekti i rivlerësimit është i mirë organizuar, eficient dhe efektiv.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

61.10 Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Anisa Qilimi, merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Krujë, për periudhën objekt rivlerësimi. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim, duke konsideruar se në të gjitha rastet qëndrimet e organit të akuzës janë mbështetur nga gjykata.

Aftësia për të administruar dosjet

61.11 Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin më së miri me faktin penal, me qëndrimin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe disponimin e gjykatës.

Etika në punë

61.12 Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Integriteti

61.13 Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

61.14 Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i

gjuhës diskriminuuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

Aftësitë e komunikimit

61.15 Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në 3 dokumentet e dorëzuara prej tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

Aftësia për të bashkëpunuar

61.16 Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Gatishmëria për t'u angazhuar

61.17 Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Anisa Qilimi, i nënshtrohet Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Lidhur me trajnime të tjera, të kryera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit, prokurorja Anisa Qilimi, ka qenë pjesëmarrës në disa aktivitete të zhvilluara si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit.

DENONCIMET

62. Pranë Komisionit janë protokolluar tetë denoncime për subjektin, si më poshtë vijon:

62.1 Denoncim me nr. *** prot., datë 23.11.2017, paraqitur nga shtetasi S.P drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe një subjekti tjetër, Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë. Nga administrimi i këtij denoncimi dhe dokumentacionit bashkëlidhur tregohet ndër të tjera se dy prokurorët kanë shpërdoruar detyrën, nëpërmjet korrupsionit për të pushuar procedimin penal lidhur me kallëzimin nr. ***, datë 30.6.2016, për veprën penale “shpërdorim detyre” ndaj ekspertës topografes B.L, e cila në një çështje gjyqësore civile (konflikt pasurie paluajtshme) ku denoncuesi ka qenë në cilësinë e paditësit ka kryer veprime të ndërmarra jo në përputhje me ligjin. Në këtë denoncim, denoncuesi ka referuar faktet që ka cituar në kallëzim dhe që lidhen me ushtrimin e detyrës nga ekspertja në kundërshtim me ligjin, pasi kjo eksperte ka marrë përsipër detyra për të cilat nuk është e licencuar me licencën që disponon, nuk ka treguar të vërtetën para gjykatës, ka kryer evazion fiskal duke mos lëshuar faturën për shërbimin e kryer etj., fakte të kundërligjshme, për të cilat prokurorja duhet të kishte nisur procedimin e jo ta pushonte duke arsyetuar se vendimi i gjykatës nuk ka marrë formë të prerë.

62.1.1 Denoncim me nr. *** prot., datë 23.1.2018, i paraqitur përsëri nga shtetasi S.P. Komisioni e administroi këtë denoncim dhe vuri re të shkruara të njëjtat fakte si në denoncimin e parë.

62.2 Komisioni i vlerësoi faktet e referua në denoncimet më lart dhe e ftoi subjektin e rivlerësimit të paraqiste shpjegimet lidhur me këto denoncime.

62.3 Subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara lidhur me këtë denoncim, se:

*“Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasis S. P është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, datë 9.5.2017. Materiali kallëzues i është deleguar shërbimeve të policisë gjyqësore dhe konkretisht OPGj-së J. B. Shtetasi S. P ka kërkuar fillimin e procedimit penal ndaj shtetases B. L, inxhinier topograf gjeodezi me nr. Licence TZ ***, datë 26.4.2007, për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, si dhe “ekspertimit të rreme”. Shtetasi S.P është pyetur në cilësinë e deklaruës, dokumentuar me*

procesverbal, rreth faktit objekt kallëzimi, si dhe ka paraqitur aktet shkresore në mbështetje të pretendimeve të tij.

Është vlerësuar se për të gjitha pretendimet lidhur me përmbajtjen e aktit të ekspertimit, mangësitë e tij, kallëzuesi ka të drejtë nëpërmjet instrumenteve procedural civil të parashtrojë pretendimet e tij gjatë gjykimit civil, për sa kohë vendimi nuk kishte marrë formë të prerë. ”

62.4 Subjekti ka vijuar shpjegimet se : *Në këtë kontekst nuk ka pse organi i akuzës, si organ i ushtrimit të ndjekjes penale, të ndërhyjë në një proces gjyqësor civil dhe të mbaje anë në këtë proces. Në këto kushte është vendosur në datën 13.7.2017 mosfillimi i procedimit penal lidhur me materialin kallëzues nr. ***/2017. Vendimi i është komunikuar me shkresë përcjellëse shtetasit S.P. Subjekti ka paraqitur në Komision kopje të njëzuar të akteve të materialit kallëzues nr. ***/2017, mosfilluar me vendimin e datës 13.7.2017.*

62.5 Denoncim me nr. ***, datë 26.1.2019, paraqitur nga shtetasi A.B drejtuar 19 subjekteve përfshirë subjektin e rivlerësimit. Sipas këtij denoncimi, subjektet kanë marrë vendime në kundërshtim me Kushtetutën dhe mbi bazën e dokumenteve fals duke i shkaktuar dëme. Subjekti ka bashkëlidhur disa vendime të dhëna nga subjektet të cilët ka denoncuar, ndër ta, edhe vendimi për mosfillimin e procedimit me nr. *** regj., të vitit 2017 marrë nga subjekti i rivlerësimit më 17.3.2017.

62.6 Komisioni e administroi këtë vendim nga ku evidentoi se subjekti i rivlerësimit ka administruar faktet e paraqitura në kallëzim, ka kryer veprime të natyrës verifikuese (duke marrë në pyetje edhe vetë kallëzuesin), ka vlerësuar aktet e materialit kallëzues dhe në përfundim ka vendosur mosfillimin e procedimit duke e arsyetuar vendimin, si dhe duke orientuar kallëzuesin mbi mënyrën e zgjidhjes së të drejtave të tij të ankimit.

62.7 Denoncim me nr. *** prot., datë 4.2.2019, paraqitur nga shtetasi B. Sh. Ky denoncim si fillim i është paraqitur Komisionerit Publik protokolluar me nr. *** prot., datë 21.11.2018, përcjellë shkresërisht pranë Komisionit. Ky denoncues është ankuar se ka dy vjet që ka paraqitur kallëzim penal në prokurori për falsifikim dokumentesh ndaj shtetasit I. H, i cili ka grabitur pronën e tij dhe prokurorja, subjekti i rivlerësimit, nuk e ka thirrur asnjëherë për të dëgjuar pretendimet e tij dhe as nuk është në dijeni për ecurinë e çështjes.

62.8 Komisioni i vlerësoi faktet e referuara në denoncimin më lart dhe e ftoi subjektin të paraqiste shpjegime lidhur me këtë denoncim, si dhe dokumentacion ku mbështeste shpjegimet.

62.9 Lidhur me këtë denoncim, subjekti ka referuar veprimet procedurale ndjekur për të.

*“Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, datë 29.9.2017, me kallëzues shtetasin B. Sh. Kallëzuesi B. Sh kallëzon shtetasin I. H, pasi sipas kallëzuesit shtetasi I. H me dokumente të falsifikuara i kërkon lirinë e tokës prej 2200 m² të cilën e disponon me certifikatë pronësie të lëshuar në datë 28.7.2003. Me urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore të datës 5.10.2017, shërbimet e policisë gjyqësore janë ngarkuar të pyesin në cilësinë e deklaruës shtetasit B. Sh dhe I.H. Nga tërësia e veprimeve ka rezultuar se kallëzuesi dhe i kallëzuari janë palë në një proces gjyqësor civil, të iniciuar nga shtetasi B. Sh. ...Duke qenë se kallëzuesi dhe i kallëzuari kanë një konflikt të natyrës juridike-civile lidhur me pretendime pronësie, të cilat shqyrtohen në gjykatë civile, është vendosur mosfillimi i procedimit penal me vendimin e datës 16.10.2017. Vendimi mosfillimit i është dërguar me shkresë nr. *** prot., date 30.10.2017, shtetasit B. Sh, në adresën e ndodhur në zarrfin e plotësuar nga ana e tij, bashkëlidhur kallëzimit penal, si dhe në adresën e deklaruar përpara oficerit të policisë gjyqësore. ”*

62.10 Gjithashtu, lidhur me pretendimin e shtetasit B.Sh se nuk është takuar me prokuroren e çështjes, subjekti ka sqaruar se: *“Nuk me rezulton asnjë kërkesë për takim. Jo domosdoshmërisht prokurori mund të marrë takim me çdo kallëzues, varet nga lloji dhe rëndësia e çështjes, ngarkesa në punë etj.”*

62.11 Subjekti ka paraqitur në Komisionit kopje te njësuar të akteve të materialit kallzues Nr. ***/2017, mosfilluar me vendimin e dates 16.10.2017,

62.12 Denoncim me nr. *** prot., datë 2.3.2020, paraqitur nga R.V ndaj disa subjekteve përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, të cilët kanë shqyrtuar çështjen e saj (civile dhe penale) për një konflikt pasuror. Lidhur me subjektin e rivlerësimit, denoncuesja pretendon se ka shkelur ligjin lidhur me hetimin e çështjes penale ndaj Noteres M.Sh, e kallëzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”. Denoncuesja ka paraqitur një panoramë të plotë rreth pretendimeve të saj, duke theksuar, ndër të tjera, se subjekti i rivlerësimit ka kryer një hetim të vaket: Konkretisht lidhur me këtë pikë denoncuesi me fjalë të tjera ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në cilësinë e provës të gjitha kartelat shëndetësore që lidheshin me gjendjen shëndetësore të të ndjerit S. B, të cilat mund t’i vinte në dispozicion të mjekes ligjor të caktuar për të nxjerrë konkluzionin e plotë dhe pa ekuivokë lidhur me gjendjen e tij psikike dhe as nuk ka marrë në pyetje familjarët nëse kartelat ishin apo jo të mjaftueshme për të vlerësuar gjendjen shëndetësore në kuadër të hetimit. Gjithashtu, në dosjen e hetimit ka qenë i depozituar një akt tjetër ekspertimi i kryer mbi bazën e një vendimi gjykate (në kuadër të konfliktit gjyqësor civil me përfaqësuesit me prokurë të të ndjerit S. B), sipas të cilit është paraqitur një konkluzion krejtësisht i ndryshëm nga ai i përgatitur nga ekspertja mjeko ligjore, në kuadër të hetimit penal dhe subjekti nuk e ka vlerësuar këtë provë në kuadër të hetimit. Denoncuesja në denoncim ka pretenduar se subjekti nuk ka arsyetuar as shkaqet ligjore që e çuan në marrjen e vendimit për pushimin e procedimit penal.

62.13 Komisioni i vlerësoi faktet e referuara në denoncimin më lart dhe ftoi subjektin të paraqiste shpjegime lidhur me denoncimin, si dhe dokumentacion ku mbështeste shpjegimet, kryesisht duke ndaluar në sqarimin e disa çështjeve, si më poshtë:

- Në kuptim të kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, a është administruar nga Ju akti i ekspertimit i përgatitur nga psikologjia D.B lidhur me gjendjen emocionale, psikologjike të të ndjerit S. B, akt i cili paraqet fakte të marra nga deklarimet e vetë familjarëve që kanë jetuar ngushtësisht me të (p. sh. bashkëshortja), lidhur me diagnozën e tij?

- A është administruar akti i ekspertimit psikologjik i cili jep fakte se të ndjerit i mungonte komunikimi, nuk ishte i ndërgjegjshëm për veprimet, për shkak të gjendjes shëndetësore të tij të dinamizuar që nga viti 2008, fakte këto që janë kontradiktore me pohimin e noteres (referuar fakteve të paraqitura në vendimin e pushimit të procedimit), se i ndjeri ka qenë i qartë në komunikim?

- A është arsyetuar vlera e raportit psikologjik, i përgatitur nga psikologjia D. B në raport me provat e tjera të përfutuara nga hetimi i kryer për këtë çështje?

- A janë marrë në pyetje familjarët e të ndjerit S. B lidhur me gjendjen shëndetësore të tij dhe a i është kërkuar atyre historiku i plotë që lidhej me diagnozën shëndetësore të të ndjerit për t’ia vënë në dispozicion ekspertës së caktuar, me qëllim të qartësimit të çështjes së zotësisë së plotë për të vepruar nga ana e të ndjerit S.B, në kuadër të kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm?

62.14 Lidhur me konstatimet e Komisionit, subjekti në shpjegimet e saj, ka paraqitur informacion lidhur me regjistrimin e këtij procedimi dhe hapat e ndjekura, si më poshtë:

*“Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është regjistruar procedimi penal, nr. ***, datë 1.6.2018, për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, mbi bazën e informacionit referues nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë.*

Shtetase R. V ka bërë kallëzim penal ndaj kallëzuarës noteres M. Sh.

Procedimi penal është ndjekur në vijosmi nga tri prokurorë: Y.P, zëvendësuar për shkak komandimi në një tjetër detyrë. Më pas procedimi penal është ndjekur nga prokurore A. N, zëvendësuar për shkak komandimi në një tjetër detyrë. Prokurore Anisa Qilimi, e cila ka ndjekur çështjen në përfundim dhe vendosur për zgjidhjen ligjore të çështjes. Subjekti ka sqaruar se ka qenë prokurore e çështjes për periudhën nga data 9.5.2019-31.7.2019.”

Subjekti ka vijuar me paraqitjen e një analize ligjore lidhur me procedimin, objekt denoncimi:

Sipas ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë” i ndryshuar, në nenin 45 përcaktohet se: “Identiteti i çdo personi pjesëmarrës në aktin noterial merret nëpërmjet letërnjoftimit ose të një dokumenti tjetër që jep besim të plotë në këtë drejtim, përveç kur është i njohur prej tij. Noteri duhet të sigurohet edhe për zotësinë e tyre të plotë për të vepruar. Kur ka dyshim, kërkon e merr raport mjekësor. Të gjitha këto përmenden shprehimisht në akt”.

Sipas nenit 46 të po këtij ligji, aktet nënshkruhen rregullisht nga palët dhe nga pjesëmarrësit në akt në prani të noterit, duke shkruar emrin e mbiemrin e plotë. Kur ndonjëra nga palët nuk di të shkruajë, autorizon të nënshkruajë për të një person tjetër, për identitetin e të cilit noteri sigurohet njëjloj si dhe për palët.

Në interpretim të dispozitave ligjore si më lart, legjislatori e ka lënë në vlerësim të noterit, nëse do të duhej të kërkohej dhe administrohej raport mjekësor për t’u siguruar për zotësinë e plotë për të vepruar për S.B.

Në çështjen objekt hetimi nuk rezulton që S. B nuk dinte të shkruante, kontrata premtim shitje të nënshkruar prej tij.

*Për sa më sipër nuk u provua që noterja M. Sh të ketë konsumuar veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duke vepruar në mos përmbushje të rregullt të detyrës në aplikim të nenit 45 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar. Mbështetura në sa më sipër, në tërësinë e akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2018, duke analizuar elementet e veprës penale të “shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, konkludohet me kërkesë për pushimin e procedimit penal.*

*Kërkesa për pushimin e çështjes nr. ***/2018, është pranuar dhe Gjykata e Shkallës së Parë, e cila me vendimin nr. *** Akti, datë 22.10.2019, ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. ***/2018. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. **, datë 20.1.2020”.*

62.15 Lidhur me gjetjen e Komisionit nëse është administruar akti i ekspertimit i përgatitur nga psikologjia D.B sa i përket gjendjes emocionale, psikologjike të të ndjerit S. B, i cili paraqet fakte kontradiktore me pohimin e noterës lidhur me mungesën e komunikimit, e ndërjegjes të të ndjerit, subjekti ka paraqitur këto shpjegime:

*“Akti i ekspertimit të psikologes D. B ka qenë pjesë e fashikullit hetimor në momentin që ky procedim penal më është caktuar për ndjekje të mëtejshme (përkatësisht në datën 9.5.2019). Akti i ekspertimit ka qenë pjesë e materialit referues, përcjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me shkresën nr. ***/k prot., datë 2.5.2018. Materiali referues ka marrë nr.*

kallëzimi ***, datë 4.5.2018. Nga prokurori i çështjes Y. P është vendosur regjistrimi i procedimit penal nr. ***, datë 1.6.2018.

Me ndryshimet e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, prokurori, si përfaqësues i organit të akuzës, me bazë ligjore nenin 329/a të Kodit të Procedurës Penale bën kërkesë në gjykatë për pushimin e akuzës ose çështjes. Nuk kam marrë vendim për pushimin e procedimit.”

62.16 Lidhur me gjetjen e Komisionit, nëse është arsyetuar vlera e raportit psikologjik, i përgatitur nga psikologjia D.B në raport me provat e tjera të përfutuara nga hetimi i kryer për këtë çështje, subjekti ka paraqitur këto shpjegime:

*“Në momentin procedural të regjistrimit të procedimit penal, nuk kam qenë prokurorja e çështjes. Por, pavarësisht këtij fakti konstatoj se me të drejtë është konsideruar vlera e raportit psikologjik, si një indicie mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal. Po kështu konstatoj se në dinamikë të hetimit, me të drejtë nisur nga rekomandimet e psikologes D. B, rekomandime për gjykatën civile, prokurorja e çështjes A. N ka deleguar kryerjen e një aktekspertimi psikiatriko-ligjor nga ekspertë të IML-së, duke i vënë në dispozicion këtyre të fundit kartelat mjekësore të të ndjerit S. B. Akti i ekspertimit psikiatriko-ligjor nr. **, përgatitur nga dr. I.A, eksperte mjeko-ligjore, kryer gjatë hetimit paraprak të procedimit penal nr. ***/2018, burim prove në kuadër të një hetimi të plotë e të gjithanshëm, është cituar në kërkesën për pushim çështjeje (f. *, paragrafi *, kërkesë për pushim çështjeje nr. **/viti 2018). Theksoj se çështja penale nr. ***/2018 më është caktuar për ndjekje të mëtejshme pasi janë kryer veprimet hetimore, përkatësisht në datën 9.5.2019, pra, pasi është kryer aktekspertimi nga ekspertja e Institutit të Mjekësisë Ligjore I.A. Zgjidhja ligjore është vendosur me përgjegjshmëri të plotë, mbi rrethanat e faktit, analizën ligjore, me logjikë juridike, mbështetur në aktet e procedimit penal duke i vlerësuar provat në harmoni me njëra-tjetrën dhe pa i dhënë një vlerë të paracaktuar.”*

62.5.6 Subjekti ka paraqitur para Komisionit kopje të njësuar të akteve të fashikullit hetimor nr. ***/2018, për të dokumentuar sa më lart paraqitur.

62.6 Denoncim nr. ***, datë 20.11.2018 paraqitur nga shtetasja S. I ndaj subjektit të rivlerësimit që ka hetuar çështjen penale të ngritur ndaj ish-drejtoreshës së përgjithshme të arkivave N. N lidhur me nxjerrjen e disa dokumenteve të pronësisë të një konflikti gjyqësor për disa prona në Sarandë, të trashëguara nga gjyshi i denoncueses, çështje e pushuar, si dhe ndaj një subjekti tjetër i cili ka shqyrtuar kërkesën për pushimin e procedimit penal.

62.6.1 Denoncuesja ka bashkëlidhur dokumentacion, ku e bazon denoncimin e saj, nga administrimi i të cilit evidentohen pretendime të denoncueses se subjekti i rivlerësimit e ka zvarritur hetimin dhe në fund e ka pushuar me argumentin e zbatimit të parimit të “sigurisë juridike” duke ngatërruar gabimisht këtë procedim me atë të çështjes “J”, i cili nuk ka asnjë lidhje me kallëzimin ndaj shtetasës N. N.

62.6.2 Komisioni i vlerësoi faktet e referuara në denoncimin më lart dhe e ftoi subjektin e rivlerësimit të paraqiste shpjegime.

62.6.3 Lidhur me këtë denoncim, subjekti ka shpjeguar se veprimet hetimore të kryera në kuadër të procedimit penal nr. ***/2018, kanë qenë të plota dhe hetimi ka qenë i gjithanshëm dhe dinamik, duke pasqyruar veprimet procedurale të ndjekura lidhur me këtë procedim. Subjekti ka vijuar me paraqitjen e veprimeve procedurale:

“Kallëzimi penal është bërë nga shtetasit H.Ç, M.Sh. dhe S.I. Kallëzimi drejtohet ndaj shtetasës N.N. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, kallëzuesit kanë kallëzuar penalisht për përdorim dokumenti të falsifikuar shtetasit Th. J dhe K.J. Por,

kallëzuesit, gjithashtu kanë ngritur pretendimet edhe për shkelje në aktivitetin e znj. N. N, si Drejtoreshë e Arkivit Qëndror Shtetëror (f.**, fashikulli *, procedimi penal nr. ***/2016). Në këto kushte është kërkuar shkresërisht në Prokurorinë e Sarandës kopje e fashikullit të procedimit penal dhe është administruar kopje e dosjes hetimore nr. *, të vitit 2013 me kallëzues H. Ç dhe të kallëzuar familja J, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Nga analiza në përmbajtje të fashikullit hetimor rezultoi se: me vendimin e datës 23.3.2014 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. **/viti 2013, regjistruar për veprën penale ‘falsifikim dokumentesh’, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, mbi bazë kallëzimi të shtetasit H. Ç. Hetimi i procedimit penal nr. **/2013 i Prokurorisë Sarandë, për sa më lart është shtrirë detyrimisht dhe në aktivitetin e AQSH-së, referuar akteve të fashikullit hetimor. Ndërsa për sa i përket pretendimeve të shtetasës S.I, për fitimin e pronësisë nga familja J, mbi bazën e dokumenteve të rreme, këto të dhëna identifikohen në procesverbalin e pyetjes si deklaruese datë 16.11.2016 (f. **-**, fashikulli parë, procedim nr. ***/2016 të Prokurorisë Tiranë) dhe nuk ka asnjë konfondim.

Mbështetur në sa më lart, nga analiza në përmbajtje të fashikullit hetimor rezultoi se pretendimet e shtetasve S. I, M.Sh dhe H. Ç, për shkelje të rënda nga shtetase N. N, si Drejtoreshë e Arkivit Qendror, rezultoi se janë trajtuar dhe kanë marrë zgjidhje ligjore në kuadër të hetimit të hetimit të procedimit penal nr. **/2013 të Prokurorisë Sarandë”.

62.6.4 Subjekti ka përfunduar shpjegimet, se:“Nuk ka pasur zvarritje pavarësisht karakterit voluminoz të çështjes nr. ***/viti 2016, të cilën do ua vë në dispozicion, bashkëlidhur parashkrimeve. Nëse do të analizohej përmbajtja e dosjes hetimore nr. **/2014 në Sarandë dhe objekti kallëzimit në çështjen nr. ***/2016 rezultoi objekti i kallëzimit shtrirë në kohë është i njëjtë, ndërsa subjektet e kallëzuar janë të ndryshëm”.

62.6.5 Subjekti ka paraqitur para Komisionit kopje të njësuar të akteve të procedimit.

62.7 Denoncim nr. **, datë 19.12.2018 dhe denoncim nr. **, datë 24.12.2018 paraqitur nga shtetasi J. B ndaj subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerësimin e kriterit të figurës. Në këto denoncime të përsëritura janë cituar të njëjtat pretendime se subjekti i rivlerësimit, për kryerjen e veprimeve të saj korruptive, përdor oficerët e policisë gjyqësore. Denoncuesi shprehet, konkretisht, se në një kallëzim penal të bërë ndaj përmbartës I. G, në dhjetor 2016, pas kalimit rreth një viti e gjysmë nga kallëzimi, OPGJ-të i kanë kërkuar ryshfet që të hetonin thellësisht kallëzimin dhe se denoncuesi nuk ka pranuar e, për rrjedhojë, i është ngritur akuza kryesisht nga subjekti për mashtrim. Denoncuesi nuk ka referuar të dhëna të detajuara për çështjen penale dhe as ka bashkëlidhur dokumentacion.

62.7.1 Subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime mbi këtë denoncim.

62.7.2 Në shpjegimet e saj, subjekti ka paraqitur një panoramë të plotë të veprimeve procedurale, dhe ka sqaruar lidhur me pretendimet e shprehura në denoncim, se:

“Për veprimet në shkelje të ligjit nga OPGJ-të nuk kam qenë në dijeni. Kam qenë prezent gjatë pyetjes së shtetasit J.B dhe komunikimi ka qenë shumë korrekt me të pandehurin dhe me policinë gjyqësore. Policia gjyqësore në kryerjen e veprimeve hetimore në këtë procedim penal ka qenë në kontroll të vazhdueshëm. Fashikulli është kontrolluar dhe deleguar pesë herë me detyra të mirëpërcaktuara, nisur nga natyra e veçantë e rastit.

J. B, nëse do të ishte siç thotë ai, që në momentin e parë ka pasur detyrimin ligjor të adresojë në organet kompetente për çdo veprim në shkelje të ligjit nga oficerët e policisë gjyqësore apo dhe prokurorit të çështjes. Të gjithë jemi të barabartë përpara ligjit dhe kemi detyrimin ligjor të reagojmë ndaj shkeljes së ligjit”.

62.8 Denoncim datë 7.4.2020 i paraqitur nga shtetasi G. H nëpërmjet postës zyrtare elektronike të Komisionit, për një problem pronësie me një firmë ndërtimi, të cilën e ka kallëzuar edhe në Prokurorinë e Tiranës. Procedimi po shqyrtohet aktualisht nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi pretendon se çështja po zvarritet rreth dy vite nga subjekti pa marrë asnjë masë sekuestro ndaj firmës së ndërtimit, ndërkohë që i plotëson të gjitha kushtet ligjore.

62.8.2 Komisioni i kërkoi subjektit të paraqiste shpjegimet për sa pretendon denoncuesi.

62.8.3 Subjekti ka shpjeguar se çështja penale nr. ***/2017 paraqitet në hetim, duke pasqyruar edhe dinamikën e veprimeve të kryera:

*“Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. **, datë 13.2.2017 për veprën penale ‘ndërtim pa leje’, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Procedimit penal nr. ***, datë 13.2.2017 i janë bashkuar përkatësisht edhe procedimet penale nr. ***, datë 8.3.2017, procedimi penal nr. ***, datë 6.3.2017 dhe procedimi penal nr. ***, datë 21.3.2017. Në kuadër të procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, të cilit i janë bashkuar edhe procedimet penale si më lart, është përpiluar akt njoftim akuze për shtetasin D. Ll. Aktualisht çështja penale nr. **, datë 13.2.2017 paraqitet në hetim, përqendruar dhe në aktivitetin e punonjësve të ish-Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe është drejt dhënies së zgjidhjes ligjore. Çështja penale është hetuar dhe ka kaluar në katër prokurorë, të cilët janë zëvendësuar për shkaqe procedurale. Çështja penale është tepër voluminoze dhe aktualisht ka kaluar mbi 3500 faqe. Duhet pasur parasysh edhe ngarkesa e punës së prokurorit. Kam mbartur rreth 80 dosje nga viti i shkuar, vetëm për vitin 2020 deri në këtë moment kam pasur në shqyrtim mbi 140 materiale procedurale. Ngarkesa paraqitet e lartë ndërmjet procedimeve, ju përmend procedimin ***/2020 regjistruar për veprën penale ‘vrasje me dashje’ dhe ‘mbajtje pa leje të armëve luftarake’, ngjarje e zbuluar dhe e ndjekur në mënyrë rigorozë. Ju përmend gjithashtu procedimin nr. ***/2019, ku vetëm gjatë muajit shkurt falë një hetimi impenjativ dhe në bashkëpunim me policinë e shtetit u arrestuan në flagrancë 115 shtetas”.*

62.8.4 Komisioni ka vlerësuar të administrojë në këtë hetim ndaj subjektit të rivlerësimit edhe faktet të bëra publike nga burime të hapura mediatike²⁶ lidhur me procedimin penal ndaj shtetasit A P, i cili përplasi për vdekje duke kaluar në vija të bardha viktimën, të ndjerin G. M. Vajza e viktimës ka bërë apel të hapur në media se prokurorja e çështjes Anisa Qilimi ka kërkuar 2 vjet e 6 muaj burgim për të pandehurin, ndërkohë, gjykata ka vendosur 3 vjet burg për drejtuesin e mjetit. Gjykata ka vendosur më shumë masë dënimi sesa ka kërkuar prokuroria. Vajza e viktimës në media ka replikuar se pas përplasjeve që pati me prokuroren, një ditë para vendimit kur jepej pretenca, prokurorja Qilimi kërkoi vetëm 2 vjet e 6 muaj burgim për drejtuesin e mjetit, ndërkohë që ligji parashikonte dënime nga 2 vjet deri në 10 vjet për aksidente me pasojë vdekjen.

62.8.5 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me veprimet hetimore, vendimin për procedim të shtetasit A.P, si dhe i kërkoi subjektit kopje të dosjes së plotë hetimore.

62.8.6 Subjekti ka paraqitur shpjegime të detajuara lidhur me këtë çështje, si më poshtë:

*“Mbi bazën e referimit të veprës penale nga policia gjyqësore, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2018 për veprën penale ‘shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor’, të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit A.P. Lidhur me këtë procedim janë kryer këto veprime procedurale:është bërë kqyrje e vendit të ngjarjes, në përmbajtje të të cilit është bërë dhe këqyrja e mjetit të sekuestruar me*

²⁶https://360_grade.al/122305/aksidenti-fatal-qe-i-mori-jeten-biznesmenit-te-kepuceve-paralajmerimi-i-vajzes-pas-vendimit-te-gjykates/

targa HD ** U, shoqëruar me skicën dhe me tabelën fotografike, këqyrje e viktimës G. M, janë marrë vendimet përkatëse për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor dhe atij autoteknik, si dhe janë administruar aktet përkatëse.

Nisur nga sa më sipër është bërë arrestimi në flagrancë për shtetasin A.P. Si përfaqësuese e organit të akuzës kam kërkuar caktimin e masës së sigurisë ‘arrest me burg’, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në shtëpi’. Kam ushtruar ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit ka pranuar ankimin dhe hetimi dhe gjykimi për të dënuarin A.P. ka vijuar me masën e sigurisë ‘arrest ne burg’, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Unë, subjekti rivlerësimit Anisa Qilimi, me përgjegjshmëri të plotë deklaroj se nuk kam pasur asnjë përplasje me vajzën e të ndjerit. Gjatë hetimit të çështjes penale kam qenë unë, subjekti i rivlerësimit që kam ushtruar ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe kam kërkuar që shtetasi A. P të hetohej dhe më pas kuptohet, të gjykohej me masën e sigurisë ‘arrest me burg’, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.”

62.8.7. Subjekti ka paraqitur para Komisionit kopje të njësuar të akteve të fashikullit hetimor nr. ***/2018, hetuar për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit A.P.

63. Komisioni analizoi denoncimet e mësipërme, faktet e njohura sipas ligjit nr. 84/2016, shpjegimet e dhëna, provat e paraqitura nga subjekti dhe konstatoi se subjekti arriti të shpjegojë sa u kërkuar në lidhje me këto denoncime. Trupi gjykues arriti në përfundimin se në këto nuk ka denoncime elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurores.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anisa Qilimi, me detyrë prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
2. Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të transferojë procedimin penal nr. **, të vitit 2014, pranë organit kompetent për inspektim.

3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
 4. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë më 28.7.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha

